



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 120

Datë 4 gusht 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 487, datë 22.7.2014	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Shërbimi Informativ i Shtetit te Ministria e Kulturës, të pronës së paluajtshme shtetërore, me emërtimin “Objekti “Gjethi””, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 502, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, me karakter sekret, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar.....	5589
Vendim i KM nr. 488, datë 22.7.2014	Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës.....	5594
Vendim i KM nr. 489, datë 22.7.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Plepa - Kavajë - Rrogozhinë (loti 10, me rrugët dytësore).....	5595
Vendim i KM nr. 490, datë 22.7.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass, Plepa - Kavajë - Rrogozhinë” (loti 7, rrugët dytësore).....	5597
Vendim i KM nr. 491, datë 22.7.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës - Qafëthanë.....	5599

Vendim i KM nr. 492, datë 22.7.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (kultura bujqësore dhe drurë frutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan – Tepelenë.....	5601
Vendim i KM nr. 493, datë 22.7.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	5602
Vendim i KM nr. 494, datë 22.7.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 678, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, vënia në punë, administrimi e mirëmbajtja e hidrocentraleve të Gojanit, Gjegjanit, Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangut”.....	5607
Vendim i KM nr. 495, datë 22.7.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 693, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar””, të ndryshuar.....	5608
Vendim i KM nr. 497, datë 22.7.2014	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 394, datë 10.4.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoriteteve kontraktuese, përkatësisht, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, për dhënien me koncesion të ndërtimit të landfillit për trajtimin e mbetjeve të qarkut të Durrësit dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë “Albania Landfill Energy” A.L.E.....	5609
Urdhër i Kryeministrit nr. 190, datë 23.7.2014	Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.....	5609
Kërkesë e MTI nr. 3275/4, datë 18.7.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Plepa-Rrogozhinë” (loti 7, objektet me rrugën dytësore)...	5614
Vendim GjAA nr. 7, datë 18.6.2014	Me objekt shfuqizimin e udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 1665/1, datë 5.3.2014, “Për caktimin e tarifave përmbarimore dhe shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat” si akt i dalë në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit.....	5615

VENDIM
Nr. 487, datë 22.7.2014

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT, NGA SHËRBIMI
INFORMATIV I SHTETIT TE MINISTRIA E
KULTURËS, TË PRONËS SË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, ME EMËRTIMIN “OBJEKTI
“GJETHI””, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 502, DATË 18.7.2003, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
ME KARAKTER SEKRET, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT
INFORMATIV SHTETËROR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Shërbimi Informativ i Shtetit te Ministria e Kulturës, të pronës së paluajtshme shtetërore, me emërtimin

“Objekti “Gjethi””, adresa: rruga “4 Shkurti”, Tiranë, ndodhur në zonën kadastrale 8380, me sipërfaqe të përgjithshme 1 667,06 (një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje zero gjashtë) m² dhe sipërfaqe ndërtese 513,66 (pesëqind e trembëdhjetë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) m², sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi, për çeljen e muzeut me materiale autentike, të përdorura nga Drejtoria e Sigurimit të Shtetit dhe riprodhime të ndryshme.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 502, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Kulturës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama


1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror MINISTRIA E KULTURËS										
Bashkia : TIRANË										
Fusha e përdorimit te Prones: ZYRA DHE AMBIENTE TË TJERA NDIHMËSE										
Nr. Rend.	A			B			C			
	Z. Kadastr. Ind. i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8380			Objekti "Gjethi" Rruga "4 Shkurti" TIRANE	1667.06	513.66	Zyra dhe ambiente të tjera ndihmës sipas kateve total m ²	Ministria e Kulturës	Ministria e Kulturës	
				nga këto:						
				Zyra dy kat Administratë		401.89	792.69			
				Garazhe 1 kat		58.32	58.32			
				Objekt 1 kat magazinë		36.24	36.24			
				Vend roje 1 kat		17.21	17.21			

PLANVENDOSJE SHK.1:500

OBJEKT NË ADMINISTRIM TË SHISH-it






PLAN RILEVIMI	
22300 PERGATITI SAGA Nr.T _____ Dt. ____/____/____ data e pergatitjes 04.03.2010 PASURIA 6/333 ME S_T = 96.25 M² 6/349 NAKHET ME S_T = 12.94 M² 6/350 ME Vula / Firma S_T = 57.31 M² 6/351 ME S_T = 26 M²	IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8380 NR.LPASURISE 6/333 VOL 20 FO 199 INDEKSI I HARTES TR-P-11 SHKALLA 1:500 ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F _____ R/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____ PRONARI/ET SHFET

PLAN VENDOSJE SHK. 1 : 500 0322

OBJEKTI "GJETHI" (NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË SHIS



VENDIM
Nr. 488, datë 22.7.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT FAVORIZUES
TË SHITJES SË PARCELËS NDËRTIMORE PËR
NDËRTIMET PA LEJE ME FUNKSION BANIMI
DHE TË PËRZIER, TË SUBJEKTEVE QË
PËRFITOJNË FALJE TË PAGESËS, SI DHE TË
MËNYRËS E AFATEVE TË PAGESËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. ÇMIMI I SHITJES SË PARCELËS
NDËRTIMORE PËR OBJEKTET ME FUNKSION
BANIMI DHE TË PËRZIER**

1. Çmimi i shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi (përfshirë dhe shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtime me leje), llogaritet si përqindje mbi vlerën e pronës, sipas llojit “tokë truall”, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Për ndërtimet pa leje me funksion banimi, çmimi i shitjes për një metër katror është 50% e vlerës së përcaktuar për pasurinë “tokë truall”, në njësinë administrative dhe zonën kadastrale përkatëse.

Për ndërtimet pa leje të ndërtuara brenda territorit administrativ të komunave, kur çmimi për metër katror, i përlllogaritur sipas kësaj pike, është më i vogël se 400 (katërqind) lekë apo më i madh se 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë, çmimi që do të aplikohet për shitjen e parcelës ndërtimore do të jetë në këto vlera kufi.

Për ndërtimet pa leje, të ndërtuara brenda territorit administrativ të bashkive, kur çmimi për metër katror, i përlllogaritur sipas kësaj pike, është më i vogël se 500 (pesëqind) lekë apo më i madh se 2 000 (dy mijë) lekë, çmimi që do të aplikohet për shitjen e parcelës ndërtimore do të jetë në këto vlera kufi.

Për shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtime me leje, me funksion banimi, pavarësisht nga territori ku ato janë ngritur, kur çmimi për metër katror, i përlllogaritur sipas kësaj pike, është më i vogël se 1 000 (një mijë) lekë apo më i madh se 3 000 (tre mijë) lekë, çmimi që do të aplikohet për sipërfaqen përkatëse do të jetë në këto vlera kufi.

3. Për ndërtimet pa leje me funksion të përzier (banim dhe social-ekonomik), çmimi i shitjes së parcelës ndërtimore llogaritet në raport me sipërfaqen e ndërtimit pa leje, që shfrytëzohet për secilin nga funksionet e mëposhtme:

a) Sipërfaqja e parcelës ndërtimore, në raport me sipërfaqen e ndërtimit pa leje që shfrytëzohet për funksion social-ekonomik, shitet sipas vlerës së pronës, të llojit “tokë truall”, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) Sipërfaqja e parcelës ndërtimore, në raport me sipërfaqen e ndërtimit pa leje që shfrytëzohet për banim, shitet sipas çmimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

**II. KATEGORITË E SUBJEKTEVE QË
PËRFITOJNË FALJE TË PAGESËS**

4. Për poseduesit e ndërtimeve pa leje, që kanë statusin e invalidit paraplegjik dhe/ose tetraplegjik, në kuptim të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me paraqitjen e dëshmisë zyrtare përkatëse pranë drejtorisë së varësisë së ALUIZNI-t, detyrimi financiar për vlerën e parcelës ndërtimore falet.

Për poseduesit e ndërtimeve pa leje, që kanë në përbërjen familjare persona me statusin e invalidit paraplegjik dhe/ose tetraplegjik, detyrimi financiar për parcelën ndërtimore zbritet në masën 50% nga vlera e llogaritur në bazë të kreut I të këtij vendimi.

5. Poseduesit e ndërtimeve pa leje, që janë subjekte të ndihmës ekonomike, në kuptim të ligjit nr. 9355, datë 9.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, përfitojnë zbritje në masën 30% nga vlera e parcelës e llogaritur në bazë të kreut I të këtij vendimi.

**III. MËNYRA DHE AFATET E PAGESËS SË
PARCELËS NDËRTIMORE, SI DHE PËRQINDJET E
PËRDORIMIT TË BONOVE TË PRIVATIZIMIT**

6. Shlyerja e vlerës së parcelës ndërtimore nga poseduesi i ndërtimit pa leje bëhet pas njoftimit me shkrim nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), në të cilin janë përcaktuar vlera, mundësia për pagesën në pjesë, si dhe afatet e shlyerjes.

Pagesë e menjëhershme do të konsiderohet shlyerja nga poseduesi i ndërtimit pa leje i vlerës së parcelës ndërtimore, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit me shkrim.

7. Paga e detyrimit financiar për parcelën ndërtimore, pavarësisht nga funksioni i objektit pa leje, mund të kryhet:

a) në lekë, në vlerë të plotë monetare;

b) me bono privatizimi, deri në 50% të vlerës së parcelës.

8. Për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, pagesa e vlerës së parcelës ndërtimore bëhet menjëherë.

9. Nëse pagesa e vlerës së parcelës ndërtimore kryhet menjëherë, përfitohet zbritje prej 20% nga vlera e mbetur e detyrimit, pavarësisht nga funksioni i ndërtimit pa leje.

Kjo zbritje përfitohet edhe për vlerën e parcelës ndërtimore për objektet e dyta pa leje, sipas përcaktimeve të nenit 25, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Në kuptim të kësaj pike, vlerë e mbetur e detyrimit, konsiderohet ajo e përftuar pas aplikimit të rregullit të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 7, të këtij vendimi.

10. Nëse poseduesi i ndërtimit pa leje nuk e shlyen plotësisht detyrimin financiar për parcelën ndërtimore brenda një viti nga data e njoftimit, do të zbatohen përcaktimet e pikës 2/1, të nenit 30, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, deri në pagesën e vlerës totale të detyrimit.

11. Si garanci për shlyerjen e detyrimeve vjetore kontraktore të furnizimit me energji elektrike mbi vlerën e mbetur të parcelës ndërtimore të objektit pa leje aplikohet një zbritje prej 10%.

Nëse subjekti dëshmon se, brenda një viti nga data e njoftimit mbi pagesën e parcelës ndërtimore, ka kryer rregullisht shlyerjen e detyrimeve të furnizimit me energji elektrike, vlera e garancisë falet.

12. Për detyrimet e parcelës ndërtimore, të llogaritura, por të pashlyera nga poseduesit deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të aplikohen çmimet, mënyra dhe afatet e përcaktuara në këtë vendim.

13. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 489, datë 22.7.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
PLEPA - KAVAJË – RROGOZHINË (LOTI 10, ME
RRUGËT DYTËSORE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Plepa – Kavajë – Rrogozhinë (loti 10, me rrugët dytësore).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë arë dhe truall, me sipërfaqe të përgjithshme prej 35 929 (tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë) m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 16 073 831 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 16 073 831 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Detyrimet e prapambetura (detyrimet e infrastrukturës)”.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Rikonfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konflikt pronësie”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 5, 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

11. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONAREVE QE SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR " By-Pass Plepa Rrogozhinë" Loti 10

Nr	Emri	Mbiemri	Zona	Nr.	Lloji i pasurisë	Sip.	Çmimi	Vlera	Shënime
	Fshati Lekaj								
1	Rifat	Uku	2399	194/1	arë	1039	344	357416	Rikonfirmim pranë ZVRPP
2	Pellumb	Uku	2399	194/2	arë	97	344	33368	Rikonfirmim pranë ZVRPP
3	Hysen	Uku	2399	194/3	arë	96	344	33024	Rikonfirmim pranë ZVRPP
4	Telha	Cullhaj	2399	194/4	arë	163	344	56072	Rikonfirmim pranë ZVRPP
5	Sulejman	Gjumsi	2399	194/5	arë	183	344	62952	Rikonfirmim pranë ZVRPP
6	paidentifikuar		2399	195	arë	4259	344	1465096	Konflikt pronësie
7	paidentifikuar		2399	280	arë	4438	344	1526672	Konflikt pronësie
8	Esat	Beu	2399	133/17	arë	41	344	14104	Rikonfirmim pranë ZVRPP
9	Shaban	Gjeci	2399	133/18	arë	7	344	2408	Rikonfirmim pranë ZVRPP
10	Bakushe	Gjeci	2399	133/4	arë	33	344	11352	Rikonfirmim pranë ZVRPP
11	Vath	Gjeci	2399	133/5	arë	55	344	18920	Rikonfirmim pranë ZVRPP
12	Jakup	Kercuku	2399	133/17	arë	64	344	22016	Rikonfirmim pranë ZVRPP
13	Besim	Korri	2399	133/7	arë	32	344	11008	Rikonfirmim pranë ZVRPP
14	Hysni	Doda	2399	193/1	arë	558	344	191952	Rikonfirmim pranë ZVRPP
15	Reshat	Korri	2399	201/1	arë	199	344	68456	Rikonfirmim pranë ZVRPP
16	Bedri	Korri	2399	201/2	arë	116	344	39904	Rikonfirmim pranë ZVRPP
17	Ramazan	Korri	2399	201/3	arë	82	344	28208	Rikonfirmim pranë ZVRPP
18	Rexhep	Korri	2399	201/4	arë	229	344	78776	Rikonfirmim pranë ZVRPP
19	Nazmi	Stafa	2399	201/6	arë	50	344	17200	Rikonfirmim pranë ZVRPP
20	Latif	Korri	2399	201/7	arë	77	344	26488	Rikonfirmim pranë ZVRPP
21	Hajdar	Tafa	2399	201/8	arë	64	344	22016	Rikonfirmim pranë ZVRPP
22	Mustafa	Tafa	2399	201/9	arë	123	344	42312	Rikonfirmim pranë ZVRPP
23	Tafil	Tafa	2399	201/10	arë	106	344	36464	Rikonfirmim pranë ZVRPP
24	Agim	Uku	2399	201/11	arë	138	344	47472	Rikonfirmim pranë ZVRPP
25	Lirim	Uku	2399	201/16	arë	87	344	29928	Rikonfirmim pranë ZVRPP
26	Gezim	Uku	2399	201/12	arë	37	344	12728	Rikonfirmim pranë ZVRPP
27	Mehmet	Uku	2399	201/13	arë	87	344	29928	Rikonfirmim pranë ZVRPP
28	Bashkim	Uku	2399	201/14	arë	286	344	98384	Rikonfirmim pranë ZVRPP
29	Bashkim	Uku	2399	201/15	arë	123	344	42312	Rikonfirmim pranë ZVRPP
30	Bexhet	Kercuku	2399	279/1	arë	15	344	5160	Rikonfirmim pranë ZVRPP
31	Jakup	Kercuku	2399	279/11	arë	23	344	7912	Rikonfirmim pranë ZVRPP
32	Dervish	Kercuku	2399	279/10	arë	55	344	18920	Rikonfirmim pranë ZVRPP
33	Riza	Uku	2399	281/1	arë	88	344	30272	Rikonfirmim pranë ZVRPP
34	Mexhit	Uku	2399	281/2	arë	72	344	24768	Rikonfirmim pranë ZVRPP
35	Nezir	Uku	2399	281/3	arë	58	344	19952	Rikonfirmim pranë ZVRPP
36	Ndricim	Uku	2399	281/4	arë	26	344	8944	Rikonfirmim pranë ZVRPP
37	Njazi	Uku	2399	281/5	arë	65	344	22360	Rikonfirmim pranë ZVRPP
38	Zija	Uku	2399	281/6	arë	50	344	17200	Rikonfirmim pranë ZVRPP
39	Misir	Uku	2399	281/7	arë	34	344	11696	Rikonfirmim pranë ZVRPP
40	Rahim	Uku	2399	281/8	arë	116	344	39904	Rikonfirmim pranë ZVRPP
41	Bexhet	Uku	2399	281/9	arë	274	344	94256	Rikonfirmim pranë ZVRPP
42	Mevlud	Halili	2399	281/13	arë	51	344	17544	Rikonfirmim pranë ZVRPP
43	Xhemil	Uku	2399	281/14	arë	126	344	43344	Rikonfirmim pranë ZVRPP
44	Gezim	Uku	2399	281/19	arë	77	344	26488	Rikonfirmim pranë ZVRPP
45	Ilir	Uku	2399	281/20	truall	58	1257	72906	Rikonfirmim pranë ZVRPP
46	Mynyr	Uku	2399	281/21	truall	77	1257	96789	Rikonfirmim pranë ZVRPP
47	Alush	Uku	2399	281/22	arë	420	344	144480	Rikonfirmim pranë ZVRPP

	Fshati Gosë e Madhe								
48	Beqir	Saraci	1814	62/2	arë	1165	512	596480	Rikonfirmim pranë ZVRPP
49	Bp	Saraci	1814	195/3	arë	691	512	353792	Rikonfirmim pranë ZVRPP
50	bp Shehu Saraci		1814	195/4	arë	1920	512	983040	Rikonfirmim pranë ZVRPP
51	Adem	Shehu	1814	195/17	arë	3008	512	1540096	Rikonfirmim pranë ZVRPP
52	Vullkan	Saraci	1814	195/10	arë	554	512	283648	Rikonfirmim pranë ZVRPP
53	BP	Saraci	1814	195/11	arë	935	512	478720	Rikonfirmim pranë ZVRPP
54	Nuh	Saraci	1814	201/8	arë	1060	512	542720	Rikonfirmim pranë ZVRPP

55	Ejup	Saraci	1814	201/9	arë	1003	512	513536	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
56	Reshit	Saraci	1814	201/10	arë	888	512	454656	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
57	Osman	Saraci	1814	201/11	arë	1290	512	660480	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
58	Osman	Saraci	1814	210/1	arë	639	512	327168	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
59	Tahir	Saraci	1814	201/12	arë	1080	512	552960	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
60	Kapllan	Saraci	1814	201/13	arë	982	512	502784	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
61	Shaban	Saraci	1814	201/14	arë	1270	512	650240	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
62	Mehmet	Saraci	1814	201/15	arë	792	512	405504	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
63	Idriz	Saraci	1814	201/21	arë	1102	512	564224	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
64	Beqir	Saraci	1814	201/22	arë	764	512	391168	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
65	Sali	Saraci	1814	201/2	arë	44	512	22528	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
66	Zabit	Saraci	1814	201/3	arë	118	512	60416	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
67	Azem Share	Saraci	1814	201/4	arë	208	512	106496	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
68	Sokol	Saraci	1814	201/5	arë	298	512	152576	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
69	Mynyr	Saraci	1814	201/6	arë	256	512	131072	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
70	Shpetim	Saraci	1814	201/7	arë	315	512	161280	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
71	Xhavit	Saraci	1814	201/24	arë	748	512	382976	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
72	Valbona	Baja	1814	62/11	arë	145	512	74240	Rikonfirmim pranë ZVRPP	
73	Kapllan	Saraci	1814	211/5	arë	100	512	51200	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së	
TOTALI								16073831		

VENDIM**Nr. 490, datë 22.7.2014**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “BY-
PASS, PLEPA - KAVAJË - RROGOZHINË” (LOTI
7, RRUGËT DYTËSORE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass, Plepa – Kavajë – Rrogozhinë” (loti 7, rrugët dytësore).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë arë dhe truall, me vlerë 173 753 243 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 173 753 243 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Detyrimet e prapambetura” (detyrimet e infrastrukturës).

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

Lista e pasurive që shpronësohen nga ndërtimi i By-Pass "Plepa-Kavajë-Rrogozhinë"

Loti 7 me rrugët dytësore dhe mbikalim (tokat)

Nr.	Pronari			Zona kad.	Nr /pas	Sip. m ²	Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	B/pronare		Xhahysa	3554	299/39	383	arë	377	144391	konfirmuar nga ZVRPP
2	Petrit		Todia	3554	299/19	840	arë	377	316680	konfirmuar nga ZVRPP
3	Ali		Todia	3554	299/18	43	arë	377	16211	konfirmuar nga ZVRPP
4	Asllan		Todia	3554	299/20	174	arë	377	65598	konfirmuar nga ZVRPP
5	Zyber		Çullhaj	8552	1/153	959	truall	16700	16015300	konfirmuar nga ZVRPP
6	Gezim		Çala	8552	1/165	206	truall	16700	3440200	konfirmuar nga ZVRPP
7	Xhaferr		Zhelegu	8552	1/154	1630	truall	16700	27221000	konfirmuar nga ZVRPP
8	B/pronare		Biturku	8552	1/150	300	truall	16700	5010000	konfirmuar nga ZVRPP
9	Rustem	Tafil	Kaja	8552	10/270	233	truall	16700	3891100	konfirmuar nga ZVRPP
	Suzana	Rrahman	Kaja							
10	Agron		Elezi	8552	10/50	117	truall	16700	1953900	konfirmuar nga ZVRPP
11	Xhavit		Kollcaku	8552	10/232	164	arë	359	58876	konfirmuar nga ZVRPP
12	Jakup		Kollcaku	8552	10/62	498	truall	16700	8316600	konfirmuar nga ZVRPP
13	Idriz		Kollcaku	8552	10/61	258	truall	16700	4308600	konfirmuar nga ZVRPP
14	Muharrem		Kollcaku	8552	10/60	321	truall	16700	5360700	konfirmuar nga ZVRPP
15	Jani		Papa	8552	12/287	300	truall	14800	4440000	konfirmuar nga ZVRPP
16	Astrit		Hallulli	8552	12/289	244	arë	359	87596	konfirmuar nga ZVRPP
17	Tasim		Dervishaj	8552	12/290	212	arë	359	76108	konfirmuar nga ZVRPP
18	Qani		Hoxha	8552	12/291	153	arë	359	54927	konfirmuar nga ZVRPP
19	Qani		Hoxha	8552	12/253	146	truall	14800	2160800	konfirmuar nga ZVRPP
20	Aleksander + Marieta		Proda	8552	12/315	291	truall	14800	4306800	konfirmuar nga ZVRPP
21	Aviol		Pepa	8552	12/257	760	arë	359	272840	konfirmuar nga ZVRPP
22	Sulejman		Allajbej	8552	12/297	125	arë	359	44875	konfirmuar nga ZVRPP
23	Idriz		Kasa	8552	12/298	178	arë	359	63902	konfirmuar nga ZVRPP
24	Vullnet		Kollcaku	8552	12/296	424	arë	359	152216	konfirmuar nga ZVRPP
25	Avni		Lila	8552	12/311	609	truall	14800	9013200	konfirmuar nga ZVRPP
26	Besnik		Allajbej	8552	12/274	250	truall	14800	3700000	konfirmuar nga ZVRPP
27	Hashim		Kurti	8552	12/278	388	arë	359	139292	konfirmuar nga ZVRPP
28	Edi		Hasalliu	8552	12/330	263	arë	359	94417	konfirmuar nga ZVRPP
29	Rexhep		Çeka	8552	12/307	238	arë	359	85442	konfirmuar nga ZVRPP
30	Rexhep		Çeka	8552	12/309	253	arë	359	90827	konfirmuar nga ZVRPP
31	B/pronare		Hoxha	8552	12/331	450	truall	14800	6660000	konfirmuar nga ZVRPP
32	Fatbardha		Perja	8552	12/231	237	arë	359	85083	konfirmuar nga ZVRPP
33	Fatbardha		Perja	8552	12/230	227	arë	359	81493	konfirmuar nga ZVRPP
34	Hafsa		Biba	8552	12/314	230	arë	359	82570	konfirmuar nga ZVRPP
35	Luan		Zoto	8552	12/312	257	arë	359	92263	konfirmuar nga ZVRPP
36	Shqipe		Kazazi	8552	12/284	203	arë	359	72877	konfirmuar nga ZVRPP
37	Ismet & Arben		Oxhallari	8552	12/293	670	arë	359	240530	konfirmuar nga ZVRPP
38	Artan Shyti			8552	12/299	390	truall	14800	5722000	konfirmuar nga ZVRPP
39	B. Duhaxhiu Gentian Lila			8552	12/44	360	truall	14800	5328000	konfirmuar nga ZVRPP
40	B/Pr Bekshiu			8552	12/336	310	truall	14800	4588000	konfirmuar nga ZVRPP
41	Dhurata		Cara	8552	12/137	395	arë	359	141805	konfirmuar nga ZVRPP
42	Qefsere		Velecia	8552	12/206	392	arë	359	140728	konfirmuar nga ZVRPP
43	Naime		Popoj	8552	12/211	400	arë	359	143600	konfirmuar nga ZVRPP
44	Mirsie		Metolli	8552	12/212	379	arë	359	136061	konfirmuar nga ZVRPP
45	Qazim		Okshuni	8552	12/213	410	arë	359	147190	konfirmuar nga ZVRPP
46	Flamur		Okshuni	8552	12/214	400	arë	359	143600	konfirmuar nga ZVRPP
47	Ardian		Bacaj	8552	12/215	818	arë	359	293662	konfirmuar nga ZVRPP
48	Vasip		Okshuni	8552	12/324	568	arë	359	203912	konfirmuar nga ZVRPP
49	Ylli		Sinani	8552	12/321	52	arë	359	18668	konfirmuar nga ZVRPP
50	Hidajet		Xhihani	8552	12/322	643	arë	359	230837	konfirmuar nga ZVRPP
51	Vasip		Okshuni	8552	12/323	627	arë	359	225093	konfirmuar nga ZVRPP
52	Rasim		Okshuni	8552	12/326	207	arë	359	74313	konfirmuar nga ZVRPP
53	Rasim		Okshuni	8552	12/325	777	arë	359	278943	konfirmuar nga ZVRPP
54	Mirazh		Shkodra	8552	18/362	641	truall	14800	9486800	konfirmuar nga ZVRPP
55	Mirazh		Shkodra	8552	18/361	1258	truall	14800	18618400	konfirmuar nga ZVRPP
56	Fatos + Vullnet		Demrozi	8552	18/6	41	truall	14800	606800	konfirmuar nga ZVRPP
57	Xhevat		Hoxha	8552	18/370	24	arë	359	8616	konfirmuar nga ZVRPP
58	Xhevat		Hoxha	8552	18/367	32	arë	359	11488	konfirmuar nga ZVRPP
59	Xhevat		Hoxha	8552	18/373	128	arë	359	45952	konfirmuar nga ZVRPP
60	Naxhie		Dimni	8552	18/307	106	arë	359	38054	konfirmuar nga ZVRPP
61	Limon		Celislami	8552	18/308	252	arë	359	90468	konfirmuar nga ZVRPP
62	Indrit		Çela	8552	18/403	188	arë	359	67492	konfirmuar nga ZVRPP
63	Indrit		Çela	8552	18/406	197	arë	359	70723	konfirmuar nga ZVRPP
64	Nazmi + Hamid		Arkaxhiu	8552	18/401	252	arë	359	90468	konfirmuar nga ZVRPP
65	Indrit		Çela	8552	18/407	217	arë	359	77903	konfirmuar nga ZVRPP
66	Bashkepronesi			8552	18/409	260	arë	359	93340	konfirmuar nga ZVRPP
67	Reshat		Dimni	8552	18/404	239	arë	359	85801	konfirmuar nga ZVRPP

68	Hamdi		Myftiu	8552	18/425	670	truall	14800	9916000	konfirmuar nga ZVRPP
69	Artur		Simaku	8552	18/360	540	arë	359	193860	konfirmuar nga ZVRPP
70	Ylber		Demrozi	8552	18/349	135	arë	359	48465	konfirmuar nga ZVRPP
71	Ylber		Demrozi	8552	18/352	151	arë	359	54209	konfirmuar nga ZVRPP
72	Shaban + Rabiha		Xhihani	8552	18/216	230	arë	359	82570	konfirmuar nga ZVRPP
73	Noljan		Muqolli	8552	18/218	250	arë	359	89750	konfirmuar nga ZVRPP
74	B/pr Kazazi			8552	18/280	130	arë	359	46670	konfirmuar nga ZVRPP
75	B/pr Kazazi			8552	18/284	112	arë	359	40208	konfirmuar nga ZVRPP
76	Selim		Zenelaj	8552	18/286	306	truall	14800	4528800	konfirmuar nga ZVRPP
77	Zeqine		Lilamani	8552	18/359	404	arë	359	145036	konfirmuar nga ZVRPP
78	Arben		Alia	8552	18/424	420	arë	359	150780	konfirmuar nga ZVRPP
79	Afrim		Lilamani	8552	18/293	292	arë	359	104828	konfirmuar nga ZVRPP
80	Bledar		Rrokja	8552	18/410	181	arë	359	64979	konfirmuar nga ZVRPP
81	Bujar		Bogdani	8552	18/411	242	arë	359	86878	konfirmuar nga ZVRPP
82	Kujtim		Xhuti	1212	145/15	515	truall	1397	719455	konfirmuar nga ZVRPP
83	Dritan		Hushi	1212	145/13	550	arë	342	188100	konfirmuar nga ZVRPP
84	Lutfi		Kalaja	1212	145/29	287	arë	342	98154	konfirmuar nga ZVRPP
85	Shonila		Goreja (Kalaja)	1212	145/26	568	arë	342	194256	konfirmuar nga ZVRPP
86	Xhavit		Shima	1212	145/28	197	arë	342	67374	konfirmuar nga ZVRPP
87	Petrit		Adhjari	1212	145/16	291	arë	342	99522	konfirmuar nga ZVRPP
88	B/Pr Kalaja			1212	145/24	300	arë	342	102600	konfirmuar nga ZVRPP
89	Shoq. Transp. Kavaje			1212	145/30	496	truall	1397	692912	konfirmuar nga ZVRPP
90	Rakip		Daka	1212	162/5	110	arë	342	37620	konfirmuar nga ZVRPP
91	Arjan		Kalaja	1212	145/23	134	arë	342	45828	konfirmuar nga ZVRPP
92	Rukije		Haveriku	1212	162/12	275	arë	342	94050	konfirmuar nga ZVRPP
93	Nexhatie		Gugashi	1212	162/13	300	arë	342	102600	konfirmuar nga ZVRPP
94	Muharrem		Kalaja	1212	145/22	314	arë	342	107388	konfirmuar nga ZVRPP
95	Nafije		Cara	1212	162/34	510	arë	342	174420	konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA					32724			173753243	

VENDIM**Nr. 491, datë 22.7.2014**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
QUKËS - QAFËTHANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës - Qafëthanë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë: tokë arë, truall dhe objekte, me vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 1 133 943 (një milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 133 943 (një milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tre) lekësh, të përballohet nga

buxheti i shtetit, zëri “Detyrimet e prapambetura” (detyrimet e infrastrukturës).

5. Shpenzimet procedurale në vlerën 1 016 000 (një milion e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe, me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë									Shënime
						ARE			TRUALL			Objekte			
						Sipërfaqe	Çmimi	Vlera	Sipërfaqe	Çmimi	Vlera	Lloji	Vlera	Totali	
	Fshati Rajcë-Fushë ZK 3203														
1	Vasil		Karaj	3203	869/30	12	235	2,820						2,820	Konfirmim ZVRPP
2	Besim		Rira	3203	869/31	12	235	2.820						2.820	Konfirmim ZVRPP
3	Luan	Bari	Collake	3203	1043/1	33	235	7,755						7,755	Konfirmim ZVRPP
4	Ramadan	Kodhel	Halili	3203	869/3	30	235	7,050						7,050	Konfirmim ZVRPP
5	Xhevahir	Destan	Collaku	3203	25/3	20	235	4,700						4,700	Konfirmim ZVRPP
6	Fatmir	N.	Collaku	3203	1043/7	30	235	7,050						7,050	Konfirmim ZVRPP
7	Destan	Iliaz	Halili	3203	869/4	45	235	10,575						10,575	Konfirmim ZVRPP
8	Avni	Sali	Collaku	3203	25/16	30	235	7,050						7,050	Konfirmim ZVRPP
9	Arben		Muca	3203	25/21	70	235	16,450						16,450	Konfirmim ZVRPP
10	Nafije	Sherif	Halili	3203	869/9	130	235	30,550						30,550	Konfirmim ZVRPP
11	Musa	Luman	Dashi	3203	844/32	16	235	3,760						3,760	Konfirmim ZVRPP
12	Musa	Luman	Dashi	3203	844/34	16	235	3,760						3,760	Konfirmim ZVRPP
13	Avni	Dalip	Hallidri	3203	844/19	20	235	4,700						4,700	Konfirmim ZVRPP
14	Musa	Halil	Beqo	3203	844/7	18	235	4,230						4,230	Konfirmim ZVRPP
15	Sherif	Halil	Beqo	3203	844/9	18	235	4,230						4,230	Konfirmim ZVRPP
16	Enver	Halil	Beqo	3203	844/8	18	235	4,230						4,230	Konfirmim ZVRPP
	Fshati Përrenjas-Fshat ZK 2925														
17	Shefki	Sadik	Karriqi									Dyqan 33 m2	721533	721,533	Konfirmim ZVRPP
	Qyteti Përrenjas ZK 2924														
18	Xhelo	Sulo	Karriqi +Bp	2924	2/301				45	2800	126000			126,000	Konfirmim ZVRPP
19	Xhelo	Sulo	Karriqi +Bp	2924	2/354				39	2800	109200			109,200	Konfirmim ZVRPP
	Fshati Qukës-Shkumbin ZK 3120														
20	Xhemal	Refat	Leka	3120	486	20	149	2,980						2,980	
	Fshati Pishkash-Qendër ZK 2969														
21	Arif	Isak	Shebegu	2969	742	20	210	4,200						4,200	Konfirmim ZVRPP
22	Qani	Isak	Shebegu	2969	619	150	210	31,500						31,500	Konfirmim ZVRPP
23	Qani	Isak	Shebegu	2969	677	80	210	16,800						16,800	Konfirmim ZVRPP
	SHUMA					788		177,210	84		235200		721533	1,133,943	

VENDIM
Nr. 492, datë 22.7.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (KULTURA
BUJQËSORE DHE DRURË FRUTORË), QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR LEVAN - TEPELENË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, si dhe në mbështetje të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (kultura bujqësore dhe drurë frutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan - Tepelenë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për kultura bujqësore me një vlerë 1 194 885 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë, për

drurë frutorë me një vlerë 4 109 745 (katër milionë e njëqind e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 5 304 630 (pesë milionë e treqind e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 020 000 (një milion e njëzet mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 304 630 (pesë milionë e treqind e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Detyrimet e prapambetura (detyrimet e infrastrukturës)”.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Republika e Shqipërisë
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Autoritetit Rrugor Shqiptar
Sektori i Shpronësimeve

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“LEVAN-TEPELENË” PËR KULTURAT BUIQËSORE DHE DRUFROTORE**

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr. Pas	Sip Shpro. m²	Kul.bujq Vlera lekë	Dru frutorë Vlera lekë	Total lekë	Shënime
FSHATI GJONC, KOMUNA CAKRAN										
1	Ismail	Qemal	Avdia	1758	9/1	307	1228		1228	Konfirmuar nga ZRPP
2	Qerim	Qemal	Avdia	1758	9/2	347	1388		1388	Konfirmuar nga ZRPP
3	Astrit	Muço	Salaj	1758	9/3	465	1860		1860	Konfirmuar nga ZRPP
4	Ferrik	Feçorr	Myftari	1758	9/5	268	1072		1072	Konfirmuar nga ZRPP
5	Kujtim	Feçorr	Myftari	1758	9/6	221	668		668	Konfirmuar nga ZRPP
6	Lefter	Feçorr	Myftari	1758	9/7	167	884		884	Konfirmuar nga ZRPP
FSHATI VARIBOB, KOMUNA CAKRAN										
7	Zahir	Ali	Alibeaj	3816	299/11	903	10800		10800	Konfirmuar nga ZRPP
8	Xhemal		Velaj	3816	42/7	4935	24675		24675	Konfirmuar nga ZRPP
FSHATI BUZË E MADHE, KOMUNA CAKRAN										
9	Ylmi	Hekuran	Bendaj	1341	223	331	3475		3475	Konfirmuar nga ZRPP
FSHATI LEVAN, KOMUNA LEVAN										
10	Rahman		Caushaj	2436	249/32	460	6650		6650	Konfirmuar nga ZRPP
11	Fadil	Hysen	Mema	2436	249/2	952		348000	348000	Konfirmuar nga ZRPP
12	Mentor		Mema	2436	249/3	877	10500		10500	Konfirmuar nga ZRPP
13	Taro	Haki	Caushaj	2436	249/5	817		232845	232845	Konfirmuar nga ZRPP
14	Gjylmore	Sadik	Caushaj	2436	249/6	1029	14700		14700	Konfirmuar nga ZRPP
15	Agron	Haki	Caushaj	2436	249/7	817	11550		11550	Konfirmuar nga ZRPP
16	Haredin	Muhamet	Lamaj	2436	249/8	1101	13200		13200	Konfirmuar nga ZRPP
17	Ilmi	Sadik	Cobo	2436	140/1	2173	26100		26100	Konfirmuar nga ZRPP
18	Laver	Qemal	Cobo	2436	139/1	1421	32100		32100	Konfirmuar nga ZRPP

19	Fuat	Qemal	Cobo	2436	139/2	1950	43950		43950	Konfirmuar nga ZRPP
20	Nexhmedin	Osmen	Fejzullai	2436	138/1	1757	10983		10983	Konfirmuar nga ZRPP
21	Begar	Sulo	Mehmetaj	2436	138/2	1068	6675		6675	Konfirmuar nga ZRPP
22	Refat	Jonuz	Braka	2436	121/36	195	2340		2340	Konfirmuar nga ZRPP
23	Nazmi		Cobo	2436	143/1	1211	145320		145320	Konfirmuar nga ZRPP
24	Tajar		Cobo	2436	142/1	925	11100		11100	Konfirmuar nga ZRPP
25	Aleks		Dulaj	2436	143/3	416	49920		49920	Konfirmuar nga ZRPP
26	Meti		Dulaj	2436	143/4	923	110760		110760	Konfirmuar nga ZRPP
27	Sedar		Dulaj	2436	143/5	697	83640		83640	Konfirmuar nga ZRPP
28	Arben		Dulaj	2436	143/6	25	3000		3000	Konfirmuar nga ZRPP
29	Bajram		Cobo	2436	140/2	2250	47250		47250	Konfirmuar nga ZRPP
30	Ali		Lanaj	2436	249/29	1518	182160		182160	Konfirmuar nga ZRPP
31	Fatos		Lanaj	2436	256/1	852	102240		102240	Konfirmuar nga ZRPP
32	Lutfi		Lanaj	2436	256/2	1056	126720		126720	Konfirmuar nga ZRPP
33	Ajet		Buxaj	2436	256/3	429	6020		6020	Konfirmuar nga ZRPP
34	Asqeri		Cobo	2436	142/2	401	4812		4812	Konfirmuar nga ZRPP
35	Petrit		Zeçaj	2436	256/5	905	10860		10860	Konfirmuar nga ZRPP
36	Ramiz		Shahaj	2436	249/16	707	4420		4420	Konfirmuar nga ZRPP
37	Elmaz		Shahaj	2436	249/17	735	10290		10290	Konfirmuar nga ZRPP
38	Avdyli		Shahaj	2436	249/19	660	9220		9220	Konfirmuar nga ZRPP
39	Nazmi		Hajdari	2436	249/26	825	11550		11550	Konfirmuar nga ZRPP
40	Hasan		Hajdari	2436	249/25	794	11130		11130	Konfirmuar nga ZRPP
41	Lavdosh		Shahaj	2436	249/20	535	16050		16050	Konfirmuar nga ZRPP
42	Hamit		Hallidri	2436	249/21	420	2625		2625	Konfirmuar nga ZRPP
FSHATI FRAKULL E MADHE, KOMUNA FRAKULL										
43	Balil	Bege	Bega	1634	3/25	3378		1852500	1852500	Konfirmuar nga ZRPP
44	Artur		Naci	1634	75/6	870		772800	772800	Konfirmuar nga ZRPP
FSHATI KLOSË, KOMUNA HEKAL										
45	Nexhip		Ismaili	2160	355/5	30		50000	50000	Konfirmuar nga ZRPP
46	Dilaver		Çalaj	2160	396	1285	21000		21000	Konfirmuar nga ZRPP
FSHATI VASJAR, KOMUNA F.MEMALIAJ										
47	Perparim		Zaçe	3719	295/12	189		27800	27800	Konfirmuar nga ZRPP
48	Bedri		Zaçe	3719	518/3	3891		810000	810000	Konfirmuar nga ZRPP
49	Nezir		Zaçe	3719	297/45	697		15800	15800	Konfirmuar nga ZRPP
Shuma							1194885	4109745	5304630	

VENDIM**Nr. 493, datë 22.7.2014**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT
TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas nenit 62 shtohet neni 62/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 62/1

Rregullat teknike të vendosjes së zonave të shërbimit në rrugë

5602

(Neni 24 i Kodit Rrugor)

1. Ky neni ka të bëjë me vendosjen dhe mënyrën e funksionimit të zonave të shërbimit.

2. Qëllimi i këtij neni është të përcaktojë rregullat teknike të vendosjes dhe mënyrat e funksionimit të zonave të shërbimit. Rregullat duhet të jenë në përputhje me sigurinë e qarkullimit për të gjithë përdoruesit e rrugës.

3. Impiantet e shpërndarjes së karburantit llogariten si pjesë e zonës së shërbimit. Ato, përfshirë dhe vendet e ndalimit, nuk duhet të zënë në asnjë rast karrexhatën.

4. Kushtet e përgjithshme:

a) Zonat e shërbimit nuk duhet të pengojnë qarkullimin dhe të kufizojnë fushëpamjen. Zonat e shërbimit duhet të jenë të vendosura në vende të përshtatshme, duke përfshirë hapësirën për mjetet në lëvizje dhe ato të ndalura, të pajisura me korsi për rritje dhe ulje shpejtësie në hyrje dhe dalje.

b) Zonat e shërbimit për rrugët e reja duhet të jenë pjesë përbërëse e projektit rrugor dhe duhet t'u përgjigjen kërkesave të sigurisë dhe rrjedhshmërisë së trafikut.

c) Zonat e shërbimit nuk mund të vendosen në afërsi të kryqëzimeve, të vendqëndrimeve të mjeteve të shërbimit publik apo në ato pjesë të rrugës me kthesë dhe me dukshmëri të dobët. Pranë daljeve janë të ndaluara të mbjellat apo tabelat, që pengojnë pamjen e drejtuesve të mjeteve që duan të rifuten në rrugë.

ç) Për rrugët urbane, lokale, si dhe ato komunale, impiantet e shpërndarjes së karburanteve duhet t'u përgjigjen të gjitha nevojave që kanë mjetet për rrugëkalim në trotuar, siç përcaktohet në nenin 45 të kësaj rregulloreje.

d) Zonat e shërbimit të reja dhe ato ekzistuese duhet t'u nënshtrohen procedurave të auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore, bazuar në udhëzimin e përbashkët nr. 9, datë 3.7.2012, të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore".

5. Përzgjedhja dhe distancat:

a) Subjektet që shfrytëzojnë zonat e shërbimit duhet të pajisen me lejet dhe autorizimet sipas legjislacionit në fuqi.

b) Zonat e shërbimit vendosen në rrjetin rrugor duke respektuar distancat e mëposhtme:

- Për autostradat, minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) km dhe maksimumi 60 (gjashtëdhjetë) km nga aksi i simetrisë së pompës/ave të furnizimit me karburant të njëërës zonë në aksin e simetrisë së pompës/ave të furnizimit me karburant të zonës së mëpasme, në drejtim të njëjtë të lëvizjes.

- Për rrugët interurbane kryesore, minimumi 10 (dhjetë) km nga aksi i simetrisë së pompës/ave të furnizimit me karburant të njëërës zonë në aksin e simetrisë së pompës/ave të furnizimit me karburant të zonës së mëpasme, në drejtim të njëjtë të lëvizjes.

- Për rrugët interurbane dytësore, minimumi 6 (gjashtë) km nga aksi i simetrisë së pompës/ave të furnizimit me karburant të njëërës zonë në aksin e simetrisë së pompës/ave të furnizimit me karburant të zonës së mëpasme, në drejtim të njëjtë të lëvizjes.

- Për rrugët urbane kryesore, jo më pak se 500 (pesëqind) m midis ekstremiteteve të njëjta të zonave të njëpasnjëshme. Kjo distancë kuptohet si rreze e matur ndaj çdo drejtimi në rrafshin horizontal.

- Për rrugët urbane dytësore dhe lokale, jo më pak se 250 (dyqind e pesëdhjetë) m midis ekstremiteteve të njëjta të zonave të njëpasnjëshme. Kjo distancë kuptohet si rreze e matur ndaj çdo drejtimi në rrafshin horizontal.

- Për autostradat dhe rrugët interurbane, zonat e shërbimit vendosen në një distancë jo më të vogël se 10 (dhjetë) metra nga kufiri rrugor. Kufiri rrugor është fundi i pronësisë rrugore ose trupi i rrugës, referuar titujve të pronësisë dhe /ose brezave të shpronësimit sipas projektit të miratuar. Në mungesë të tyre, kufiri formohet nga vija e jashtme e hendekut të sigurimit të kanalit, kur ai ekziston, ose përkatësisht nga vija e sipërme dhe e poshtme e skarpatës, nëse rruga shtrihet në terren të pjerrët.

- Për rrugët urbane dhe komunale, zonat e shërbimit vendosen në një distancë jo më të vogël se 6 (gjashtë) metra nga kufiri i rrugës.

- Për rrugët lokale, zonat e shërbimit vendosen në një distancë jo më të vogël se 7 (shtatë) metra nga kufiri i rrugës.

c) Zonat e shërbimit duhet të respektojnë një distancë prej 30 (tridhjetë) m nga pompa e shpërndarjes së karburantit deri në çdo pikë të perimetrit të godinave publike, spitale, qendra mjekësore, objekte fetare, shkolla, kopshte, çerdhe, azile, institucione publike, stadione, godina me vlera historike dhe godina të tjera ku mund të strehohen apo të qëndrojnë mbi 50 (pesëdhjetë) persona. Kjo distancë kuptohet si rreze e matur ndaj çdo drejtimi në rrafshin horizontal midis pompës së karburantit dhe çdo pike të perimetrit të godinave të sipërpërmendura.

ç) Zonat e shërbimit duhet të kenë distancë nga kryqëzimet rrugore minimumi 1 000 (një mijë) m, për rrugët interurbane kryesore, 300 (treqind) m, për rrugët interurbane të tjera, dhe 30 (tridhjetë) m, për rrugët urbane.

Zonat ekzistuese të shërbimit në rrugët urbane mund të përjashtohen nga kushti i distancës minimale nga kryqëzimet. Ato shqyrtohen rast pas rasti në bazë të kushteve të pikës 4 të këtij neni.

d) Nuk lejohet vendosja e zonave të shërbimit në qendrat e banuara me qarkullim të kufizuar të mjeteve apo në rrugët me trafik këmbësorësh e biçikletash dhe rrugë me korsi të ngushta në të cilat pengohet trafiku prej hyrjes dhe daljes.

6. Topografia e terrenit dhe pozicioni:

a) Zonat e shërbimit nuk duhet të vendosen menjëherë në afërsi të kurbëzimeve horizontale, vertikale dhe të pjerrësive gjatësore të segmenteve rrugore me jo më tepër se 4%.

b) Në autostrada dhe segmentet rrugore interurbane kryesore, ku fluksi mesatar i qarkullimit rrugor është më shumë se 3 000 mjete/24 orë, zonat e shërbimit duhet të jenë në të dyja anët e rrugës.

c) Zgjedhja e terreneve për vendosjen e zonave të shërbimit duhet të jetë e rrafshët, për të reduktuar në minimum punimet e tokës.

7. Sipërfaqet dhe organizimi:

a) Qarkullimi në zonat e shërbimit duhet të jetë në të njëjtin drejtim me lëvizjen në karrexhatën e rrugës me të cilën është lidhur.

b) Normalisht, rrugët dhe pjesët e rezervuara për parkim për automjetet, të ndara nga ato të mjeteve të rënda, duhet të vendosen në zonën e shërbimit në mënyrë të tillë që ambientet dhe ndërtesat të mund të shihen. Zona e rezervuar për parkimin e mjeteve të rënda duhet të vendoset në pjesën e prapme të zonës së shërbimit.

c) Vendet e parkimit për autobusë duhet të kenë sinjalitikë dhe elemente sigurie shtesë për pasagjerët, mundësisht, të rrethuar nga zona të mbjella me bimësi jeshile.

c) Rrugët e brendshme nuk duhet të krijojnë pika konflikti në qarkullimin e mjeteve.

d) Është e këshillueshme që pjesët midis ambienteve të jenë të ndara nga zona të mbjella me bimësi jeshile. Bimësia duhet të jetë karakteristikë e territorit të zonës.

E gjithë zona, që ndan karrexhatën me zonën e shërbimit, duhet të mbillet me bimësi jeshile, veçanërisht me bimësi që kërkon pak mirëmbajtje, por me densitet, i cili mbron mjetet që dalin nga rruga dhe parandalon këmbësorët të kapërcejnë karrexhatën.

dh) Sipërfaqja minimale e zonave të shërbimit jashtë qendrave të banuara duhet të jetë 1 500 (një mijë e pesëqind) m² për autostradat, 1 000 (një mijë) m² për rrugët interurbane kryesore dhe 800 (tetëqind) m² për rrugët interurbane dytësore.

e) Skema e përgjithshme e organizimit të lëvizjes në një zonë shërbimi jepet në aneksin 1, që i bashkëlidhet rregullores.

8. Rrugët e hyrje - daljeve në zonat e shërbimit dhe rrugët e qarkullimit në brendësi të zonës:

a) Hyrjet në zonat e shërbimit dhe daljet nga to duhet të kenë korsitë e ngadalësimit dhe të përshpejtim. Këto korsitë mund të lidhen:

- me rampat që të dretojnë për hyrjet në sheshe ose për daljet nga to apo të lidhen me qarkullimin e brendshëm;
- drejtpërdrejt me qarkullimin e brendshëm;
- drejtpërdrejt me sheshet e zonës së shërbimit.

Korsitë e ngadalësimit duhet të jenë të tilla që të lejojnë ngadalësimin në mënyrë të sigurt të mjetit që shkëputet nga karrexhata dhe hyn në rampat e hyrjes së zonës së shërbimit.

Korsitë e përshpejtimit duhet të lejojnë futjen e sigurt të mjetit në rrymën e trafikut të rrugës kryesore. Ato kanë parimisht funksionin e shkurtimit të kohës së pritjes së mjeteve që futen, si dhe mundësojnë ndalimin e mjetit në fund të rampës.

Karakteristikat gjeometrike të projektimit të korsive jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet rregullores.

b) Rrugët e qarkullimit të brendshëm të zonës së shërbimit

Këto rrugë ndahen në:

- rampa të hyrjeve/daljeve, të cilat lidhin korsitë e ngadalësimit/përshpejtimit me sheshet e qëndrimit dhe të manovrimit. Në këto rampa, shpejtësia maksimale e projektimit shkon deri në 40 km/h.

Rampat janë segmente kalimi me një drejtim lëvizjeje dhe duhet të jenë fizikisht të ndara nga rrugët e qarkullimit me mbrojtëse metalike ose me shmangës apo pengesa me sinjale drejtimi.

Për rampat duhet të kihet parasysh:

- rrezja minimale horizontale 45 m;
- pjerrësia gjatësore maksimale 6 %;
- pjerrësia tërthore maksimale 7 %.
- korsitë e qarkullimit të brendshëm, që mundësojnë

lidhjen funksionale midis shërbimeve dhe ambienteve të ndryshme. Në këto korsitë, shpejtësia maksimale e lëvizjes duhet të jetë 20 (njëzet) km/h.

Gjithashtu, duhet të ketë, brenda shesheve të qëndrimit, zona të manovrimit, për të cilat ka shpejtësi qarkullimi mjaft të reduktuar (me hapin e ecjes).

Për këto korsitë duhet të kihet parasysh veçanërisht:

- rrezja minimale horizontale 20 m;
- pjerrësia gjatësore maksimale 7 %;
- pjerrësia maksimale tërthore 3,5 %.

Gjerësia e tyre është e njëjtë me ato të korsive të përshpejtimit dhe ngadalësimit.

• zonat e parkimit dhe të manovrave. Këto zona duhet të jenë të dukshme qartë përmes sinjalistikës dhe ftojnë përdoruesit të parkojnë në mënyrë të rregullt, si për arsye sigurie, por dhe për parkim efektiv.

Përmasat minimale të vendqëndrimeve janë, si më poshtë:

- automjete-për vendqëndrime paralele 2.00 x 5.00 m;
- për vendqëndrime këndore (të pjerrëta 45° – perpendikular 90°) 2.50 x 5.00 m;
- vende për mjete të personave me aftësi të kufizuara 3.00 x 5.00 m;
- mjete të rënda 4.00 x 18.00 m;
- autobus 4.00 x 12.00 m;
- karavanë 3.70 x 6.00 m;
- motomjete 1.50 x 3.00 m.

Përmasat e mësipërme duhet të shtohen me 50 (pesëdhjetë) cm nëse ngjitur me vendqëndrimin ka një mur vertikal, bimësi ose objekt tjetër.

Gjeometria e zonave të manovrimit është e lidhur ngushtësisht me funksionimin e parkimeve. Sidoqoftë rekomandohet:

- që të evitohet manovrimi i lëvizjes mbrapa karavanëve dhe mjeteve të rënda;
- vendosja e parkimeve sa më afër me shërbimet që ofron zona;

- që të parashikohet një pjerrësi gjatësore e zonave të parkimit të mjeteve të rënda dhe të automjeteve, në drejtim paralel me drejtimin gjatësor të mjeteve, jo më shumë se respektivisht 2 deri në 3 %. Pjerrësitë tërthore, në të dyja rastet, nuk duhet të kalojnë më shumë se 4 %.

Gjerësitë e korsive të parkimit dhe të atyre të manovrave janë, si më poshtë:

<u>Automjete</u>	<u>Korsitëeqëndrimit Gjerësiakorsisë (m)</u>
-vendparkimeparalele	2.50;
- vendparkime këndore 45°	5.00;
- vendparkime këndore 90°	5.00;

<u>Korsitë e manovrimit me një drejtim lëvizjeje</u>	
-vendparkimeparaleleosekëndoreme 45°	3.50;
- vendparkime këndore 90°	6.00.

<u>Korsi të manovrimit me dy drejtime lëvizjeje</u>	
- vendparkime paralele ose këndore 45°	5.00;
- vendparkime këndore 90°	6.00.

<u>Autobuzë</u>	<u>Korsitë e qëndrimit</u>
-----------------	----------------------------

- vendparkime këndore 45 ⁰ dhe 90 ⁰	12.00
<u>Korsitë e manovrimit me një drejtim lëvizjeje</u>	
- vendparkime këndore 45 ⁰	8.00;
- vendparkime këndore 90 ⁰	16.00
	(18.00).

Mjetet e rënda Korsitë e qëndrimit- vendparkime me 45⁰ dhe 90⁰Korsitë e manovrimit me një drejtim lëvizjeje- vendparkime këndore me 45⁰ 8.00; |- vendparkime këndore 90⁰ 16.00 |Karavanë Korsitë e qëndrimit- vendparkime me 45⁰ dhe 90⁰ 6.00 |Korsitë e manovrimit me një drejtim lëvizjeje- vendparkime këndore me 45⁰ 5.00; |- vendparkime këndore 90⁰ 8.00. |

c) Në sipërfaqen e përgjithshme të zonës së parkimit duhet që 70% e sipërfaqes të jetë për parkimin e autoveturave dhe 30% për kamiona dhe autobusë.

ç) Zonat e shërbimit duhet të sigurojnë të paktën dy orë të lira parkim për të gjitha mjetet, përdorim pa kufi të tualeteve pa detyrime për shërbime të tjera, akses në të gjitha ambientet për personat me aftësi të kufizuara.

9. Ambientet:

a) Zona e shërbimit duhet të ofrojë minimalisht:

- në autostradë, stacion furnizimi me karburant dhe lubrifikante, asistencë mekanike (minimalisht kontroll dhe riparim të sistemeve të drejtimit dhe frenimit), parkim mjetesh, tualet;

- në rrugët interurbane kryesore dhe dytësore, stacion furnizimi me karburant dhe lubrifikante, asistencë mekanike minimale (gomist), tualet;

- në rrugët urbane, stacion furnizimi me karburant dhe lubrifikante, tualet.

b) Entet pronare për lëshimin e autorizimeve mund të kërkojnë ambiente shtesë në bazë të karakteristikave të rrugës dhe kushteve lokale.

c) Kombinimet kryesore të zonave të shërbimit mund të jenë:

- stacion furnizimi + bar kafe;
- stacion furnizimi + servis;
- stacion furnizimi + bar kafe + servis;
- stacion furnizimi + restorant;
- stacion furnizimi + restorant + servis;
- stacion furnizimi + restorant + hotel + servis etj.

Ambientet e mbyllura të pushimit duhet të kenë klimatizim të ajrit.

ç) Përveç këtyre ambienteve dhe parkimeve zonat duhet të kenë:

- korsitë e ngadalësimit dhe përshpejtimit;
- sistemet e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm;
- sistemet e kanalizimeve dhe largimit të ujërave;
- sistemin e ndriçimit të jashtëm;
- sinjalizim dhe shenja rrugore.

d) Sistemi elektrik i jashtëm i zonës së shërbimit duhet të instalohet sipas kërkesave të njëjta me ato të ndriçimit publik të tipit të rrugës që i shërbehet. Ndriçimi duhet të jetë optimal dhe për funksionimin e kamerave të sigurisë në ambientet e zonës së shërbimit. Duhet bërë kujdes për mosverbimin e drejtuesve të rrugës kryesore.

dh) Zonat e shërbimit duhet të kenë furnizim me ujë, mundësisht të lidhur me rrjetin publik, i cili mund të përdoret dhe për qëllime industriale (larje, VC etj.). Sistemi me ujë duhet të furnizojë dhe zonën e pushimit. Për të kursyer ujin e pijshëm rekomandohet që të ketë një sistem shpërndarjeje të pavarur uji (pusi, furnizim nga përrenjtë, liqenet etj.).

e) Në raste kur i gjithë furnizimi me ujë duhet të merret nga një sistem i pavarur, do të rekomandohet të ndërtoheshin dy rrjete të veçanta shpërndarjeje, në njërin prej të cilëve të pastrohej uji vetëm për qëllim pirjeje.

ë) Zonat e shërbimit duhet të jenë të pajisura me sistem të kullimit të shirave dhe ujërave të zeza, të lidhura me sistemet e kullimit të rrugës kryesore. Në rast se është e pamundur, atëherë këto ujëra duhet të trajtohen.

f) Zonat e shërbimit mund të kenë dhe qendra promovimesh, meqë kanë hapësira të përshtatshme dhe një nivel të lartë trafiku mjetesh.

g) Në të gjitha rastet, pajisjet sanitare fikse duhet të pastrohen lehtë, mundësisht me kontroll automatik të qarkullimit të ujërave, me dysheme të shtruara që të lahen lehtë dhe shkarkime direkte në sistemin e largimit të ujërave.

gj) Nëse ndodhen brenda ndërtesave, ato duhet të jenë me pasqyra, mbajtës sapuni dhe tharje duarsh, letër higjienike dhe vende të posaçme për materialet e pastrimit dhe punonjësit e mirëmbajtjes.

h) Të gjitha zonat e shërbimit, që ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të kenë vendin e ngarkimit të baterive për mjetet elektrike. Për ato ekzistueset ky kusht duhet të plotësohet pas një periudhe 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e vendimit.

10. Sinjalizimi rrugor dhe shenjat në rrugë:

Përveç shenjave lajmëruese përgjatë rrugëve (autostradë, rrugë interurbane etj.), zonat e shërbimit duhet të pajisen me shenja dhe sinjale të përcaktuara në rregulloren në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, për arsyet e mëposhtme:

a) Për të kufizuar shpejtësinë deri në 40 (dyzet) km/h;

b) Për të dhënë drejtimin e lëvizjes;

c) Për të evituar ndalimin jashtë zonës së parkimit;

ç) Për të informuar për shërbimet e ofruara nga zona;

d) Për të informuar në autostrada në dalje të zonës së shërbimit për distancën e zonës pasardhëse.”.

2. Pika 14, “Furnizimi me karburant”, i tabelës së karakteristikave konstruktive, teknike dhe funksionale, të rrugëve sipas klasifikimit të manualit të sinjalizimit rrugor, bashkëlidhur rregullores, shfuqizohet.

II. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Plotësimi i rregullave teknike të miratuara me këtë vendim për zonat e shërbimit ekzistues duhet të bëhet


pas 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për transportin, organet e pushtetit vendor dhe entet pronare të rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1



ANEKSI 2

Karakteristikat gjeometrike të projektimit të korsive të ngadalësimit dhe përsheptimit



Figura 1.1: Elementet e korsisë së ngadalësimit

Korsitë e ngadalësimit janë projektuar për gjatësinë e manovrimit LM dhe gjatësinë e ngadalësimit LD (figura 1.1).

Gjatësia e manovrimit LM dhe gjatësia e ngadalësimit LD përcaktohen në tabelat 1 dhe 2.

Parametri LM përshkruan gjatësinë e hyrjes në një korsi ngadalësimi. Ai varet nga shpejtësia e kryqëzimit VJ dhe përcaktohet në tabelën 1.

Tipi i rrugës	Gjatësia e hyrjes LM [m]
Autostradë	30
Interurbane kryesore	30
Interurbane dytësore	20

Tabela 1: Gjatësia e hyrjes LM

Gjatësia e ngadalësimit LD varet nga shpejtësia e kryqëzimit VJ dhe tregohet në tabelën 2.

Tipi i rrugës	Gjatësia e ngadalësimit LD[m]
Autostradë	100
Interurbane kryesore	65
Interurbane dytësore	35

Tabela 2: Gjatësia e ngadalësimit LD

Gjatësia dhe gjerësia e korsisë së ngadalësimit do të jetë:

- Autostradat:

Gjatësia e korsisë ≥ 130 m

Gjerësia e korsisë 3,5m pa bankinat

Gjerësia e rampës 6 m së bashku me bankinat

- Interurbane kryesore:

Gjatësia e korsisë ≥ 95 m

Gjerësia e korsisë 3,5m pa bankinat

Gjerësia e rampës 5 m së bashku me bankinat

- Interurbane dytësore dhe lokale:

Gjatësia e korsisë ≥ 55 m

Gjerësia e korsisë 3,5m pa bankinat

Gjerësia e rampës 5 m së bashku me bankinat

Këndi ndërmjet aksit të rrugës kryesore dhe aksit të rampës hyrëse, 30° .



Figura 1.2: Elementet e korsisë së përshpejtimit

Gjatësia dhe gjerësia e korsisë së përshpejtimit do të jetë:

- Autostradat:

Gjatësia e korsisë ≥ 300 m

Gjerësia e korsisë 3,5m pa bankinat

Gjerësia e rampës 6 m së bashku me bankinat

- Interurbane kryesore:

Gjatësia e korsisë ≥ 100 m

Gjerësia e korsisë 3,5m pa bankinat

Gjerësia e rampës 5 m së bashku me bankinat

- Interurbane dytësore dhe lokale:

Gjatësia e korsisë ≥ 70 m

Gjerësia e korsisë 3,5m pa bankinat

Gjerësia e rampës 5 m së bashku me bankinat

Këndi ndërmjet aksit të rrugës kryesore dhe aksit të rampës në dalje, 45° .

Këndi ndërmjet aksit të rrugës kryesore dhe rampës hyrëse dhe asaj në dalje të pikës së karburantit, për rrugët urbane kryesore, dytësore dhe ato lokale, është 45° .

VENDIM

Nr. 494, datë 22.7.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 678, DATË 16.1.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI, VËNIA NË PUNË, ADMINISTRIMI E MIRËMBAJTJA E HIDROCENTRALEVE TË GOJANIT, GJEGJANIT, PESHQESHIT, URA E FANIT, FANGUT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 678, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në tabelën që përmendet në pikën 1, bashkëlidhur vendimit, nënndarjet nr. 174, 250, 290, 309, 318, 319, 323, 324, 329, 362, 365, 368, 370, 371, 372, 373, 376 dhe 377 ndryshohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë objekte, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 343 143 391.70 (treqind e dyzet e tre milionë e njëqind e dyzet e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë) lekësh.

4. Fondi prej 343 143 391.70 (treqind e dyzet e tre milionë e njëqind e dyzet e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë) lekësh të përballohet nga fondet e shoqërisë “AYEN AS Energji” sh.a.”.

3. Kudo në vendim emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” të zëvendësohet me “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Nr	Numeri i Prones	Tipi Prones	Tipi Pronarit	Emri	Atesia	Mbiemri	Sip. Parcelës	Token Truall	Sip. Nderimi	Sip. gjeometrike	Zona Kadastrore	Fshati	Komuna	Qarku	Sip. Shpronësimit	Vlera e tokës Bujqësore (LEK)	Vlera e tokës truall (LEK)	Vlera e Nderitës (LEK)	Vlera e kulturave bujqësore (LEK)	VLERA TOTALE (LEK)
174	96	ARE	PRIVAT	MARK	ZEF	MARKU	642.00			642.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	642.00	274,776				274,776
250	177	ARE	PRIVAT	PJETER	NIKOLL	MARKU	347.00			347.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	347.00	148,516				148,516
290	223	ARE	PRIVAT	MARK	ZEF	MARKU	668.00			668.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	668.00	285,904				285,904
309	244	ARE	PRIVAT	NDUE	LLESH	GJOKA	7300.00			7300.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	7300.00	3,124,400				3,124,400
318	253	ARE	PRIVAT	GEG	MARK	GJOKA	550.00			550.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	550.00	235,400				235,400
319	254	ARE	PRIVAT	LEK	PJETER	GJINI	550.00			550.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	550.00	235,400			637985	873,385
323	259	ARE	PRIVAT	ZEF	KOL	MARKU	2600.00			2600.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	2600.00	1,112,800				1,112,800
324	260	ARE	PRIVAT	BARDHOK	KOL	MARKU	2600.00			2600.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	2600.00	1,112,800				1,112,800
329	264/1	ARE	PRIVAT	NDREC	PRENG	GJINI	1176.00			1176.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	1176.00	503,328				503,328
362	291	ARE	PRIVAT	KOLE	MARK	PRENGA	282.00			282.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	282.00	120,696				120,696
365	297	ARE	PRIVAT	BARDHOK	KOL	MARKU	487.00			487.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	487.00	208,436				208,436
368	300	ARE	PRIVAT	BARDHOK	KOL	MARKU	817.00			817.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	817.00	349,676				349,676
370	302	ARE	PRIVAT	BARDHOK	KOL	MARKU	907.00			907.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	907.00	388,196				388,196
371	303	ARE	PRIVAT	BARDHOK	KOL	MARKU	1363.00			1363.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	1363.00	583,364				583,364
372	304	ARE	PRIVAT	BARDHOK	KOL	MARKU	716.00			716.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	716.00	306,448				306,448
373	305	ARE	PRIVAT	BARDHOK	KOL	MARKU	935.00			935.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	935.00	400,180				400,180
376	308	ARE	PRIVAT	ZEF	KOL	MARKU	982.00			982.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	982.00	420,296				420,296
377	309	PEMTORE	PRIVAT	BARDHOK	KOL	MARKU	901.00		75.34	901.00	1304	BUKMIRE	RRESHEN	LEZHE	901.00	385,628				385,628

VENDIM

Nr. 495, datë 22.7.2014

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 693, DATË 10.11.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATINOR TË BUTRINTIT “PARK KOMBËTAR””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 1, shkronja “b”, 4/2, 6 e 13, të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 693, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të fjalisë së parë, të shkronjës “a” të pikës 4, pas fjalës “. mesdhetare .” shtohen fjalët “. dhe zona të trashëgimisë kulturore e natyrore, përfshirë

zonat arkeologjike të trashëgimisë kulturore “Park antik”.”.

b) Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1. Nënzonat e shënuara në hartë me shkronjën A3, me sipërfaqe të përgjithshme 614,3 (gjatëqind e katërmëdhjetë presje tre) ha, kalojnë në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe në përdorim të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, institucion në varësi të kësaj ministrie.”.

c) Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Ngarkohet Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit për menaxhimin e nënzoneve A3, në përdorim të saj, e cila, së bashku me komitetin e menaxhimit të këtij parku e në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojnë menaxhimin e përgjithshëm të Parkut dhe të kontrollojnë zbatimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar.”.

ç) Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohen, përkatësisht, me “ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore” dhe “ministria përgjegjëse për mjedisin”.

2. Ngarkohet Zyra e Administrimit dhe Koordinimit

të Parkut Kombëtar të Butrintit për të hartuar planin e menaxhimit të zonës.

3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për kryerjen e regjistrimit, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 497, datë 22.7.2014

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË
VENDIMIN NR. 394, DATË 10.4.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE
KONTRAKTUESE, PËRKATËSISHT,
MINISTRINË E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE DHE
MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT, PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË NDËRTIMIT TË LANDFILLIT PËR
TRAJTIMIN E MBETJEVE TË QARKUT TË
DURRËSIT DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË
"ALBANIA LANDFILL ENERGY" A.L.E.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 394, datë 10.4.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në titullin e vendimit dhe kudo në përmbajtje të tij, emërtesat "Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave" dhe "Ministria e Punëve Publike dhe Transportit" zëvendësohen, përkatësisht, me emërtesat "Ministria e Mjedisit" dhe "Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2.1 Koncesioni të jetë i formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim).".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR
Nr. 190, datë 23.7.2014

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
ORGANIKËS SË MINISTRISË SË TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës "gj", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të nenit 7, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Struktura e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Numri i punonjësve të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës të jetë, gjithsej, 117 veta.

4. Urdhri nr. 206, datë 5.11.2013, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe efektet për numrin dhe fondet buxhetore shtesë i shtrin nga momenti i miratimit të tyre në ligjin për buxhetin e rishikuar të vitit 2014 dhe hyrjen në fuqi të tij.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ORGANIKA E MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

I. MINISTËR	1
KABINETI	(7)
DREJTOR KABINETI	1
KËSHILLTAR	3
KËSHILLTAR PËR INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË	1
SEKRETAR	2
II. ZËVENDËSMINISTËR	1
SEKRETAR	1
III. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	1
SEKRETAR	1

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
IV. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE		(21)
DREJTOR I PËRGJITHSHËM		1
IV/1. DREJTORIA E POLITIKAVE TË TRANSPORTIT		(13)
DREJTOR		1
SEKTORI I POLITIKAVE TË TRANSPORTIT RRUGOR		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I POLITIKAVE TË TRANSPORTIT DETAR		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I POLITIKAVE TË TRANSPORTIT AJROR		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I POLITIKAVE TË TRANSPORTIT HEKURUDHOR		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
IV/2. DREJTORIA E POLITIKAVE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE & MBETJEVE TË NGURTA		(7)
DREJTOR		1
SEKTORI I POLITIKAVE TË RAJONALIZIMIT & UJËSJELLËS KANALIZIMEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2

SEKTORI I POLITIKAVE TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA		
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	(3)
SPECIALIST	III-b	1
		2
V. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARTEVE & MONITORIMIT		(21)
DREJTOR I PËRGJITHSHËM		1
V/1. DREJTORIA E LIÇENCIMIT & RREGULLAVE TË NDËRTIMIT		(7)
DREJTOR		1
SEKTORI I RREGULLAVE TË NDËRTIMIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I LIÇENCIMIT NË NDËRTIM & TRANSPORT		(3)
SPECIALIST	IV-a	3
V/2. DREJTORIA E MONITORIMIT		(5)
DREJTOR		1
SPECIALIST	III-b	4
V/3. DREJTORIA E QARKULLIMIT & SIGURISË RRUGORE		(5)
DREJTOR		1
SPECIALIST	III-b	4
V/4. SEKRETARIATI (SEKTORI) KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
VI. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(32)
DREJTOR I PËRGJITHSHËM		1
VI/1. DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE		(8)
DREJTOR		1
SEKTORI JURIDIK		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2

VI/2. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME		(23)
DREJTOR		1
SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT & KOMUNIKIMIT		(2)
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I ARKIV PROTOKOLLIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST ARKIV – PROTOKOLLIT	IV-b	2
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME		(14)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
MAGAZINIER		1
PASTRUES		3
SHOFER		5
NËPUNËS INFORMACIONI		4
 VII. DREJTORIA E FINANCËS		 (10)
DREJTOR		1
SEKTORI I PLANIFIKIMIT BUXHETOR		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
SEKTORI I FINANCËS		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
 SEKTORI I STATISTIKËS		 (2)
SPECIALIST	III-b	2
 VIII. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INTEGRIMIT		 (16)
DREJTOR I PËRGJITHSHËM		1
 VIII/1. DREJTORIA E PROJEKTEVE		 (9)
DREJTOR		1
SEKTORI I FONDEVE IPA		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I MENAXHIMIT TË FONDEVE TË HUAJA		(2)
SPECIALIST	IV-a	2
 VIII/2. DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN		 (6)
DREJTOR		1
SEKTORI I INTEGRIMIT & PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE		(2)
SPECIALIST	IV-a	2
 IX. DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM		 (5)
DREJTOR		1
SPECIALIST	III-b	4
 PUNONJËS GJITHSEJ		 117

KËRKESË
Nr. 3275/4, datë 18.7.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Plepa-Rrogozhinë” (loti 7, objektet me rrugën dytësore).

Subjekti kërkuar në këtë objekt është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në përputhje të vendimit nr. 138, datë 20.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë

Republika e Shqipërisë

Ministria e Transportit dhe Infrastruktures

Autoriteti Rrugor Shqiptar

Sektori i shpronësimeve

Plepa-Rrogozhine Lot1 7 Objektet dhe sheshet(investim)SHTESA per rrugët dytesore

pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e shpronësimit është 39 179 164 (tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**
Edmond Haxhinasto

Nr.	Objekti	Pronari	Vlera	Shenime
1	Karburant "Alpet"(investim)	Mirazh Shkodra	1,585,681	me leje ndertimi
2	Karburant "Kastrati"(investim)	Arian Shyti Drimon Dedej	1,396,542	me leje ndertimi
3	Banese 1 Kat	Zyber Cullhaj	3,717,743	plot.dokumentacioni
4	Banese 1 Kat	Rustem Kaja	4,095,089	Konf ZVRPP
5	Banese 2 Kat	Aleksander Proda	3,060,589	leje legalizimi
6	Banese 1 Kat	Qani Hoxha	4,007,376	Konf ZVRPP
7	Lokal Banese	Zyber Cullhaj	11,442,645	plot.dokumentacioni
8	Mur rrethues	Gezim Cela	276,979	plot.dokumentacioni
9	Shesh (investim)	Idriz Kollcaku	369,716	plot.dokumentacioni
10	Shesh (investim)	Jakup Kollcaku	282,505	plot.dokumentacioni
11	Rrethim depo	Agim Kollcaku	705,502	plot.dokumentacioni
12	Shesh rrethim	Eduart Veizi	559,224	plot.dokumentacioni
13	Shesh rrethim	Avni Lila	974,128	plot.dokumentacioni
14	Mur rrethues	Shaqir Kollcaku	170,254	plot.dokumentacioni
15	Shesh (investim)	Edi Hasalliu	1,036,318	plot.dokumentacioni
16	Shesh (investim)	Xhavit Hoxha	410,550	plot.dokumentacioni
17	Shesh(investim)	Blendi Duhaxhi Gentian Lila	1,025,236	plot.dokumentacioni
18	Shesh (investim)	Tahir Bekshiu	1,164,569	plot.dokumentacioni
19	Shesh rrethim	Fatmir Gjuzi	483,816	plot.dokumentacioni
20	Shesh rrethim	Adhjari	294,818	plot.dokumentacioni
21	Shesh rrethim	Sali Myrtja	667,600	plot.dokumentacioni
22	Shesh rrethim	Hamdi Myftiu	997,652	plot.dokumentacioni
23	Shesh rrethim	Vullnet Demrozi	454,632	plot.dokumentacioni
	TOTALI		39,179,164	

VENDIM**Nr. 7, datë 18.6.2014****NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej: Kastriot Selita, Lindita Sinanaj, Alkelina Gazidedja, Artur Malaj, Altina Nasufi, gjyqtarë, asistuar nga sekretare gjyqësore Visela Kashari, shqyrtoi në Tiranë, në seancë gjyqësore publike çështjen administrative nr. 8, Regj., që u përket palëve:

PADITËS: Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, me seli në Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga avokati Genci Çifligu me autorizimin nr. 189, Prot. datë 8.5.2014.

TË PADITUR: 1. Ministria e Financave, përfaqësuar nga Heralda Jahollari dhe Isida Koka, me autorizimin nr. 5705/3 prot., datë 20.5.2014.

2. Ministria e Drejtësisë (në mungesë)

- Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit, përfaqësuar nga Kadri Skera.

Objekti: Shfuqizimi i udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 1665/1, datë 5.3.2014, “Për caktimin e tarifave përmbauesve dhe shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbaues gjyqësor privat”, si akt i dalë në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit.

BAZA LIGJORE: Neni 10, paragrafi 2, germa “b”, i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet 10, 25, 47 e 48 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbaues gjyqësor privat” (i ndryshuar), neni 118 i Kushtetutës së RSH-së.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse, që në diskutimin e tij përfundimtar kërkoi:

- *Pranimin e padisë dhe shfuqizimin e udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë me nr. 1665/1, datë 5.3.2014, “Për caktimin e tarifave përmbauesve dhe shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbaues gjyqësor privat”, si akt i dalë në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit.*

Dëgjoi përfaqësueset e palës së paditur, Ministrisë së Financave, që në diskutimin e tyre përfundimtar kërkuan:

- *Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj e prova.*

Dëgjoi përfaqësuesin e Avokaturës së Shtetit, që në diskutimin e tij kërkoi:

- *Rrëzimin e padisë, pasi akti nënligjor normativ është i bazuar në ligj.*

Dhe vlerësoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me padinë objekt gjykimi, duke kërkuar shfuqizimin e urdhrit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 1665/1, datë 5.3.2014, “Për caktimin e tarifave përmbauesve dhe shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbaues gjyqësor privat”, duke parashtruar këto pretendime:

- *Së pari*, udhëzimi në fjalë është nxjerrë tej kompetencave që ligji nr. 10031 u ka dhënë ministrit të Financave e ministrit të Drejtësisë dhe, për më tepër, ka parashikime që kanë dalë mbi ligjin. Papajtueshmëria e aktit nënligjor me ligjin ka sjellë si rrjedhojë cenim të ushtrimit të kësaj veprimtarie. Në udhëzim, referohet se ka dalë në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 10031/2008, që njeh të drejtën e dy ministrave vetëm për të përcaktuar masën e tarifës dhe llojet e shërbimeve përmbauesve. Ndërkohë, në udhëzim janë përcaktuar edhe llojet e tarifave, gjë e cila nuk është autorizuar nga ligji. Kjo vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 118, pika 2, të Kushtetutës. Në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, është përcaktuar se tarifat të cilat duhet të aplikohen janë: “tarifa bazë”, “tarifa e shërbimit” dhe “tarifa e suksesit”. Përfshirja në udhëzim e “tarifës së suksesit”, është parashikim që bie ndesh jo vetëm me ligjin, por edhe me objektin e veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor.

- *Së dyti*, akti në fjalë cenon parimin e hierarkisë së akteve normative. Ky udhëzim, si i dalë në zbatim të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 10031, “Për shërbimin përmbaues gjyqësor privat”, duhet t’u përmbahet përcaktimeve të këtyre të fundit, duke mos tejkaluar apo mos kufizuar fushën e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë. Titujt ekzekutivë, që vihen në ekzekutim nga shërbimi gjyqësor përmbaues, janë përcaktuar në nenin 510 dhe në titullin II ndahen në ekzekutime në fusha të veçanta. Në udhëzimin nr. 1665/1 nuk parashikohet në asnjë dispozitë të tij tarifa e aplikueshme për objektin e ekzekutimit që i përket “kryerjes së një veprimi të caktuar” ose për objekte të pavlerësueshme. Mospërfshirja në ekzekutim e këtyre rasteve, duke mos i konsideruar si shërbime përmbauesve të tarifueshme, përbën tejkalim të parashikimeve të ligjit. Udhëzimi nuk mund të prevalojë mbi ligjin, pasi kjo cenon hierarkinë e akteve normative, të parashikuara në nenin 116 të Kushtetutës. Kjo cenon të drejtën e kreditorëve për ekzekutimin e vendimeve të këtij lloji, duke cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Mospërcaktimi i këtij lloji shërbimi si i tarifueshëm, e vë shërbimin përmbaues gjyqësor privat në pozita të pabarabarta në treg me shërbimin përmbaues gjyqësor shtetëror. Kjo kufizon tagrat që përmbauesve gjyqësorë u janë dhënë me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

- *Së treti*, në pikën 4.2, germa “g”, në udhëzim janë parashikuar si shpenzime, të cilat nuk mbulohen nga tarifa përmbartimore, ndër të tjera, dhe “*shpenzimet e menaxhimit të zyrës së subjektit përmbartimor*”. Kjo vë në pozita të pabarabarta debitorët, të cilët ngarkohen në fund me pagesën e këtij lloji shpenzimi në varësi të zyrës përmbartimore që ka zgjedhur kreditori.

- *Së katërti*, aspekt tjetër diskriminues i udhëzimit është edhe parashikimi i një tarife fikse lidhur me tarifën shtesë për “administrimin dhe arkivimin e dosjes përmbartimore”, të parashikuar në nenin XII/7/dh. Kjo tarifë duhet të llogaritet në mënyrë proporcionale me llojin e praktikës përmbartimore në varësi të shpenzimeve për veprimet procedurale të kryera.

- *Së pesti*, në aspektin e parimeve të teknikës legislative ky udhëzim ka gabime të mëdha në drejtim të terminologjisë së përdorur apo edhe pasaktësi që krijojnë probleme në zbatimin e tij. Aktet normative duhet të jenë të qarta dhe të mos krijojnë kontradiktoritet mes neneve të tij. Termat e përdorur duhet të jenë të njëjtë me ata të përcaktuar në ligjin, në zbatim të të cilit ka dalë ky udhëzim.

- *Së gjashti*, përcaktimi në udhëzim i çështjes së përballimit të tarifës përmbartimore dhe shpenzimeve përmbartimore, përbën tejkalim të kompetencave të dhëna nga ligji.

- *Së shtati*, udhëzimi nuk merr në konsideratë parashikimet e neneve 10 dhe 25 të ligjit nr. 10031, që parashikojnë se në kryerjen e veprimtarisë së tij përmbartuesi mbështetet mbi bazën e një modeli kontrate shërbimi që miratohet nga ministri i Drejtësisë sipas modelit që i paraqet Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Privatë. Udhëzimi ka dalë tej parashikimeve të kontratës së shërbimit të miratuar, pasi në të nuk gjejmë pasqyrim llojet e tarifave sipas këtij udhëzimi.

- *Së teti*, parashikimet e udhëzimit bien ndesh edhe me parashikimet e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” (i ndryshuar), pasi sipas udhëzimit, tarifa e suksesit duhet të merret pas kryerjes së shërbimit, kurse në nenin 11, pika “ç”, të ligjit “Për taksat kombëtare”, është parashikuar që çdo tarifë e përcaktuar si e tillë me ligje të veçanta duhet të merret para marrjes së shërbimit.

Lidhur me shkaqet e cituara më sipër, përfaqësueset e palës së paditur, Ministrisë së Financave, dhe Avokati i Shtetit prapësuan se:

- Pala paditëse nuk gëzon legjitimitet aktiv në procesin gjyqësor të iniciuar prej saj për kundërshtimin e udhëzimit nr. 1665/1, datë 5.3.2014. Neni 15 i ligjit nr. 49/2012 ka lidhur interesin e ngritjes së padisë prej shoqatave me cenimin e një interesi të ligjshëm. Ky interes konsiston në të drejtën e shkelur, në cenimin real dhe aktual, dhe jo në premisa teorike që mund të sjellin këtë cenim interesi.

- Udhëzimi nr. 1665/1, datë 5.3.2014 ka dalë në zbatim të neneve 10, germa “e”, 47, 48 e 49 të ligjit nr. 10031/2008. Ky akt nënligjor ka si objekt të tij përcaktimin e llojeve të shërbimeve përmbartimore të tarifuara dhe masën e tarifës së subjekteve përmbartuesve private gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm. Përmbajtja e nenit 10, germa “e”, të ligjit përcakton se edhe tarifat përkatëse për kryerjen e shërbimit përmbartimor gjyqësor privat përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë. Duke marrë parasysh parashikimet e nenit 118 të Kushtetutës, në rastin e “rezervës ligjore relative”, çështja konkrete mund të rregullohet edhe me akt nënligjor.

- Udhëzimi objekt shqyrtimi është në përputhje me parimin e lirisë së kontratave, i parashikuar në nenin 660 të Kodit Civil, i cili inkurajon zhvillimin e një sistemi të bazuar në treg të aktivitetit të përmbartuesve privatë. Ligji nr. 10031/2008 është i kufizuar në specifikimin e llojeve të aktiviteteve të përmbartuesve privatë. Specifikat se si mund të realizohet vënia në ekzekutim e titujve ekzekutivë u janë lënë palëve me anë të kontratës së negociimit, subjekt i parametrave të ligjit dhe çdo udhëzimi apo rregulloreje që vendoset nga dy ministritë përkatëse pas konsultimeve me Dhomën.

- Pretendimi se udhëzimi krijon tarifa të reja, përveç atyre të parashikuara në nenet 47 e 48 të ligjit nr. 10031/2008, është i pambështetur dhe i pasaktë. Këto dispozita nuk specifikojnë ndonjë lloj të veçantë tarife, por vetëm u referohen llojeve të shërbimeve përmbartimore për të cilat tarifa aplikohet, inicimit të procedurave të ekzekutimit dhe veprimeve të tjera procedurale dhe ekzekutimit të veprimeve specifike, ligjore dhe teknike, komplekse ose me shumë kohë, për të cilat mund të vendosen tarifa shtesë. Në të dyja këto dispozita, shuma e tarifës dhe llojet e shërbimeve të tarifueshme u janë lënë rregullimit me akt nënligjor.

- “Tarifa e suksesit” ka një themel të fortë në praktikën ndërkombëtare në krahasim me aktivitetet e përmbartimit, është krejtësisht vullnetare nga ana e kreditorit dhe përmbartuesit. Në asnjë pikë të udhëzimit nuk kërkohet që palët të bazojnë tarifën sipas një rezultati të suksesshëm. Udhëzimi u ka dhënë palëve mundësinë për ta realizuar këtë pagesë dhe ka vendosur shumën maksimale që mund të ngarkohet. Përcaktimi i nocionit të “tarifës së suksesit” është në përputhje me qëllimin e qartë të mekanizmit të stimuljeve të përmbartuesve gjyqësorë për të përfunduar procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë brenda një afati sa më të shpejtë. Pra, në rastin e tarifave të përmbartuesve privatë, një tarifë e suksesshme është e lejueshme nëse është rënë dakord mes palëve, me kusht që tarifa nuk i tejkalon limitet e vendosura nga udhëzimi i përbashkët.

- Pretendimet lidhur me shpenzimet që nuk mbulohen nga tarifa përbarimore (shpenzimet e menaxhimit të zyrës), janë të pabazuara në asnjë argument ligjor.

Në analizë të pretendimeve të parashtruara nga pala paditëse, prapësimeve të palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se:

Kjo Gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e çështjes objekt shqyrtimi. Lidhur me kompetencën lëndore, neni 7 i ligjit nr. 49/2012, përcakton se *“Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik”*, kurse neni 17 i po këtij ligji parashikon rrethin e mosmarrëveshjeve lidhur me aktet administrative që shqyrtohen nga gjykata administrative. Në pikën 1 germa “a” të kësaj dispozite, parashikohet se: *“1. Padia ngrihet: a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ”*.

Në rastin në gjykim konstatohet se padia është ngritur për shfuqizimin e udhëzimit të përbashkët të ministrave të Drejtësisë dhe të Financave që në vetvete përmban vullnetin e shprehur nga këto organe publike, në ushtrim të funksionit të tyre publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligjin “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij. Pra, referuar kriterëve të nenit 2, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, udhëzimi objekt kundërshtimi përbën akt normativ nënligjor.

Lidhur me kompetencën funksionale, në nenin 10, pika 2, germa “b”, të ligjit nr. 49/2012, është përcaktuar kompetenca e Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin në shkallë të parë të mosmarrëveshjeve me objekt aktet nënligjore normative.

Së dyti, Gjykata, në referim të kriterëve të nenit 15 të ligjit nr. 49/2012, mori në shqyrtim legjitimitetin aktiv të palës paditëse. Që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, ky kërkim duhet të bëhet vetëm prej atij të cilit sipas ligjit i përket e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesit, duke justifikuar në këtë mënyrë ndërhyrjen e gjykatës. Lidhur me këtë fakt, dispozita e sipërpërmendur, parashikon se: *“Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik”*.

Pra, shtrohet për diskutim çështja nëse kundërshtimi i aktit normativ nënligjor përkatës përbën të drejtë apo interes të ligjshëm që i përket palës paditëse, Dhomës

Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë. Ligji nr. 10031/2008 ka përcaktuar se përmbauesit gjyqësorë privatë organizohen në shkallë vendi ***nëpërmjet përfaqësimit profesional*** në Dhomën Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë. Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë përbëhet nga përmbauesit gjyqësorë, të cilët janë pajisur me licencë nga ministri i Drejtësisë (nenet 23, 24). Pra, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Privatë siguron përfaqësimin profesional të të gjithë përmbauesve gjyqësorë privatë. Në kushtet kur edhe udhëzimi i përbashkët objekt kundërshtimi rregullon marrëdhënie që i përkasin aspektit të veprimtarisë së përditshme profesionale të anëtarëve të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Privatë, kjo e fundit gëzon legjitimitetin e plotë aktiv për ngritjen e padisë në gjykim në kushtet kur akti i kundërshtuar shtrin efektet në veprimtarinë e gjithë përmbauesve gjyqësorë privatë, anëtarë të kësaj Dhome.

Së treti, në shqyrtimin e ligjshmërisë së udhëzimit të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr. 1665/1, datë 5.3.2014, Gjykata mban në konsideratë parashikimet e nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit:

“1. Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.

2. Në rastet kur paditësi ose kur ligji material kërkojnë nxjerrjen e një akti administrativ, gjykata e bazon vendimin e saj në situatën faktike dhe ligjore në kohën e marrjes së vendimit.

3. Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse:

a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit;

b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit;

c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

4. Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tria kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, gjykata zbaton legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.”

Sipas kësaj dispozite, në vlerësimin e ligjshmërisë së udhëzimit, objekt kundërshtimi, Gjykata vlerëson nëse ***ky akt është nxjerrë nga ministrat përkatës në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit (ligjit nr.***

10031/2008 dhe Kodit të Procedurës Civile), vetëm për të arritur qëllimin e ligjit dhe në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. Objekti i ligjit nr. 10031/2008, rregullimi i Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Privat, si formë e organizimit të shërbimit përmbartimor në Republikën e Shqipërisë, është përcaktuar në funksion të arritjes së qëllimit të tij, realizimit të veprimtarisë procedurale të përmbartuesve gjyqësorë privatë për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Qëllimi final i përcaktimit të organizimit të shërbimit përmbartimor është garantimi dhe respektimi i një procesi të rregullt ligjor edhe në fazën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Veprimtaria procedurale bazë e përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë apo privatë është përcaktuar në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile. Pikërisht në funksion të përmbushjes së kësaj veprimtarie është organizuar edhe shërbimi përmbartimor.

Neni 1 i ligjit nr. 10031/2008 ka parashikuar se “Ky ligj ka si objekt të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit përmbartimor gjyqësor privat, kriteret që duhet të përmbushin shtetasit për të ushtruar detyrën e përmbartuesit gjyqësor privat, statusin, masat disiplinore, detyrat, përgjegjësitë, tarifën, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private”. Pra, neni 1 ka përcaktuar si objekt të ligjit, midis të tjerave, edhe përcaktimin e tarifave të shërbimit përmbartimor gjyqësor privat. Por çfarë përcakton vetë ligji për realizimin e këtij objekti? Në kreun VIII të ligjit janë dhënë parashikimet lidhur me përcaktimin e tarifave, tarifën shtesë dhe rastet e pakthyeshmërisë së tarifës. Konkretisht është parashikuar:

“Neni 47

Përcaktimi i tarifave

Masa e tarifës dhe llojet e shërbimeve përmbartimore të tarifuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë. Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Privat, paguhen tarifën përkatëse, të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave.

Neni 48

Tarifa shtesë

Për veprime përmbartimore teknikisht dhe ligjërisht specifike, komplekse apo që kërkojnë kohë, përmbartuesi gjyqësor privat ka të drejtë të kërkojë pagimin e një

tarife shtesë. Kjo tarifë paguhet, sipas rastit, me një kësht të vetëm ose me disa kështe. Masa e tarifës shtesë dhe llojet e shërbimeve përmbartimore të tarifuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Dhomës Kombëtare të përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

Neni 49

Rastet e pakthyeshmërisë së tarifës

Në rastet e ekzekutimeve të pasuksesshme, kur nga përmbartuesi gjyqësor privat janë kryer në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme të gjitha veprimet procedurale, tarifën e parapaguara janë të pakthyeshme. Kur pala kreditore ka paguar vetëm tarifën e fillimit të procedurës përmbartimore dhe detyrimi përmbushet në mënyrë vullnetare nga pala debitore, brenda afateve ligjore, tarifa e fillimit të procedurës është e pakthyeshme.”.

Kurse në Kodin e Procedurës Civile lidhur me tarifën përmbartimore konstatohen këto përcaktime:

“Neni 515

Vënja në ekzekutim

Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, shtetëror ose privat me anë të përmbartuesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kreditori, përveç kërkesës për ekzekutim, duhet të paraqesë:

- a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar);*
- b) urdhrin e ekzekutimit (origjinal);*
- c) pagesën e tarifës së vënies në ekzekutim;*
- ç) sipas rastit, prokurën e personit, që përfaqëson palën kreditore.*

Neni 525

Shpenzimet e ekzekutimit

Tarifën e përcaktuar për ekzekutimin e urdhrin ekzekutiv paguhen fillimisht nga kreditori dhe pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit i ngarkohen debitorit. Shpenzimet e tjera gjatë procedurës së ekzekutimit paguhen nga pala, që i ka shkaktuar ato.”.

Në Kodin e Procedurës Civile është përcaktuar pagesa e tarifës së vënies në ekzekutim si kusht i detyrueshëm për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit. Ndërkohë neni 525 i këtij Kodi ka parashikuar detyrimin e kreditorit për pagimin fillimisht të tarifave të përcaktuara për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit, por përcaktimi i tarifave nuk është bërë në këtë Kod. Kjo për faktin se neni 515 i Kodit parashikon se ekzekutimi mund të bëhet si nga shërbimi përmbartimor shtetëror, edhe nga shërbimi përmbartimor privat dhe organizimi i secilit prej këtyre shërbimeve është bërë me ligj të veçantë. Lidhur me shërbimin përmbartimor privat është pikërisht ligji nr.

10031/2008 që parashikon autoritetin përgjegjës për përcaktimin e tarifave, si dhe mënyrën e përcaktimit të këtyre tarifave. Sipas këtij ligji, përcaktimi i tarifave përkatëse për kryerjen e shërbimit përmbartimor gjyqësor privat bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave (neni 10 germa “e”). Por neni 47 i ligjit në fjalë ka specifikuar se çfarë konkretisht mund të përcaktojnë dy ministrat kompetentë lidhur me tarifat. Sipas kësaj dispozite udhëzimi i përbashkët përcakton vetëm llojet e shërbimeve përmbartimore të tarifuar edhe masën e tarifës. Edhe tarifa shtesë e parashikuar në nenin 48 të ligjit specifik nuk është gjë tjetër veçse pagesë për veprime të tjera përmbartimore teknikisht dhe ligjërisht specifike, komplekse apo që kërkojnë kohë.

Në analizë të gjithë dispozitave të sipërpërmendura konstatohet se *“tarifa e shërbimit përmbartimor”* s’është gjë tjetër veçse pagesa, shpërblimi, për çdo shërbim përmbartimor të kryer nga përmbartuesi gjyqësor privat gjatë procedurës së ekzekutimit të urdhrat të ekzekutimit, deri në realizimin e plotë të këtij ekzekutimi. Pikërisht për këtë shkak, edhe në nenet 47 e 48 të ligjit në fjalë është përcaktuar se udhëzimi i përbashkët i dy ministrave përcakton vetëm masën e tarifës dhe llojet e shërbimeve përmbartimore të tarifuar. Pra udhëzimi i përbashkët specifikon vetëm llojin e çdo shërbimi përmbartimor të tarifuar dhe masën e tarifës për secilin prej këtyre llojeve të shërbimeve. **Pikërisht kjo është forma dhe mënyra që vetë ligji ka parashikuar për realizimin e objektivit dhe qëllimit të vet lidhur me tarifat përmbartimore, nxjerrja e një udhëzimi, i cili të specifikojë çdo shërbim përmbartimor të tarifueshëm dhe masën përkatëse të kësaj tarife. Çdo përcaktim i ndryshëm nga sa parashikon ligji lidhur me këtë udhëzim, është i kundërligjshëm.**

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 10031/2008 (nenet 47 e 48) ministri i Drejtësisë, në bashkëpunim me ministrin e Financave kanë miratuar udhëzimin e përbashkët nr. 1240/5, datë 15.9.2009, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat”. Por ky udhëzim rezultoi të jetë revokuar me udhëzimin e përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr. 1665/1, datë 5.3.2014, “Për caktimin e tarifave përmbartimore për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat”, që është edhe akti objekt kundërshtimi.

Në udhëzimin në fjalë rezultoi të jetë bërë i njëjti përcaktim lidhur me objektin si edhe në ligj. Në pikën 1 të udhëzimit është përcaktuar se: *“Ky udhëzim përcakton llojet e shërbimeve përmbartimore të tarifuar dhe masën e tarifës së subjekteve përmbartuese private gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm”*.

Kurse në kreun V, pika 2, të udhëzimit është parashikuar se *“Tarifa përmbartimore për paditë mbi vlerën 6 000 000 lekë përbëhet nga tarifa për shërbim/veprime përmbartimore dhe tarifa e suksesit, të cilat paguhen si më poshtë:*

a) Tarifa për shërbim/veprim përmbartimor do të paguhet mbi bazën e kryerjes së veprimeve procedurale përmbartimore nga ana e subjekteve përmbartimore sipas tabelës së mëposhtme...

b) Tarifa e suksesit paguhej fillimisht nga kreditori me mbledhjen e suksesshme të detyrimit përkatës apo rezultateve të tjera të suksesshme siç është rënë dakord midis palëve. Gjithsesi debitori është përfundimisht përgjegjës për pagesën e kësaj tarife në përputhje me shkronjën “c”.

c) Kosto tarifash të pagueshme nga debitori. Debitorit i ngarkohen si shpenzime të gjitha shumat e tarifës për veprimet përmbartimore, si dhe pjesa takuese e tarifës së suksesit deri në masën e përcaktuar në pikën 3 të kreut IX të këtij udhëzimi.”

Është e dukshme se krahas tarifës për shërbimet përmbartimore, në këtë udhëzim është përcaktuar edhe një tarifë e re lidhur me paditë me vlerë mbi 6 000 000 lekë, që është tarifa e suksesit. Në pikën 3 të kreut II të udhëzimit është përcaktuar se *“Tarifa e suksesit” është tarifa që i paguhet subjektit përmbartimor për padinë me vlerë më të madhe se 6 000 000 lekë, me kusht mbledhjen nga subjekti përmbartimor për llogari të kreditorit të të ardhurave (cash) apo edhe çdo procedurë tjetër e suksesshme, e përcaktuar si e tillë nga palët në kontratën përkatëse dhe e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindje të caktuar mbi vlerën e padisë, ose nëpërmjet një formule të kombinuar të të dyjave, por brenda limiteve të përcaktuara në pikën 3 të kreut IX të këtij udhëzimi”*. Në këtë mënyrë në përcaktimet e këtij udhëzimi konstatohet që krahas specifikimit të llojeve të shërbimeve të tarifueshme dhe masave përkatëse të tarifave është përcaktuar edhe një lloj i ri tarife, veç tarifës së shërbimit përmbartimor.

Në nenin 118 pikat 1 e 2 të Kushtetutës së RSH-së është përcaktuar se: *“1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.”* Edhe në nenet 47 e 48 të ligjit nr. 10031/2008 janë autorizuar ministrat e Drejtësisë dhe të Financave për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për përcaktimin e masës së tarifës, llojit të shërbimeve përmbartimore të tarifueshme, masën e tarifës shtesë dhe llojet e shërbimeve të tarifueshme (me tarifën shtesë). Por në asnjë prej këtyre dispozitave nuk autorizohen këta ministra për caktimin e tarifave të reja përmbartimore. Për më tepër konstatohet që në udhëzim

është disponuar edhe lidhur me mënyrën e pagesës së kësaj tarife, si dhe detyrimin për pagimin e saj. Kjo bën që udhëzimi nr. 1665/1 datë 5.3.2014 të mos jetë në përputhje me objektin e përcaktuar në ligj për nxjerrjen e këtij udhëzimi. **Përcaktimi i faktit nëse ky akt është nxjerrë nga ministrat përkatës në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit (ligjit nr. 10031/2008) vetëm për të arritur qëllimin e ligjit dhe në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë, rezulton në zbatimin nga organet kompetente përkatëse të parashikimeve që bën vetë ligji lidhur me autorizimin që u jep këtyre organeve për nxjerrjen e akteve nënligjore normative.** Moszbatimi nga organet kompetente në mënyrë të përpiktë dhe veprimi në tejkalim të parashikimeve të ligjit cenon objektivin dhe qëllimin e vetë ligjit.

Pretendimi i palës së paditur, përfaqësueses së Ministrisë së Financave, se ligji në nenin 10 germa “e” ka autorizuar ministrat përkatës për të përcaktuar tarifat, duke përfshirë edhe llojet e tyre, është i pabazuar dhe interpretim i gabuar i kësaj dispozite. Parashikimi i germës “e” të nenit 10 duhet parë i lidhur me parashikimet e neneve 47 e 48 të ligjit. Ndërsa neni 10 parashikon përgjegjësitë e ministrit të Drejtësisë lidhur me shërbimin përmbartimor gjyqësor privat, nenet 47 e 48 specifikojnë autorizimin përkatës për ministrin e Drejtësisë në bashkëpunim me ministrin e Financave duke përcaktuar edhe çështjet konkrete lidhur me tarifat që duhet të rregullojnë me udhëzim të përbashkët. Pra çështjet lidhur me tarifat për të cilat ligji ka autorizuar dy ministrat për të rregulluar me akt nënligjor, janë të parashikuara në nenet 47 e 48 të ligjit në fjalë. I pabazuar gjendet nga kjo gjykatë edhe pretendimi se udhëzimi nuk ka vendosur tarifa të reja, por vetëm u referohet llojeve të shërbimeve përmbartimore për të cilat tarifa aplikohet, inicimit të procedurave të ekzekutimit dhe veprimeve të tjera procedurale. Tarifa e suksesit nuk rezulton të jetë e lidhur me asnjë veprim procedural apo lloj të shërbimit përmbartimor. Suksesi është i lidhur me rezultatin final të të gjithë veprimtarisë së përmbartuesit në ekzekutimin e titullit ekzekutiv, pavarësisht veprimtarisë së tij procedurale, është i lidhur me sigurimin e përmbushjes së detyrimit nga pala debitorë dhe me shkallën e kësaj përmbushjeje.

Për sa më sipër, gjykata çmon se udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave nr. 1665/1, datë 5.3.2014, është akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, për shkak se nuk rezulton të jetë nxjerrë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit që ka autorizuar nxjerrjen e tij. Kjo mënyrë veprimi ka cenuar parimin e ligjshmërisë së organeve të administratës publike të parashikuara në nenin 9 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“1. Organet e administratës publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderohet,*

ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca”.

Në analizë të të gjitha shkaqet të sipërpërmendura, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se padia e paraqitur na Dhoma Kombëtare e Avokatëve është e bazuar në ligj e si e tillë duhet pranuar. Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr. 1665/1, datë 5.3.2014 është akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin e si i tillë duhet shfuqizuar në tërësinë e tij.

Neni 117 i Kushtetutës së RSH-së në pikën 1 parashikon se: *“1. Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.”.* Në zbatim të kësaj dispozite udhëzimi nr. 1665/1, datë 5.3.2014 ka hyrë në fuqi vetëm pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 10.3.2014. Referuar pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit *“Vendimi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, me kërkesë të gjykatës që ka dhënë vendimin, publikohet i plotë në të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit”*, kjo gjykatë mban detyrimin për t'i kërkuar Qendrës së Botimeve Zyrtare botimin e këtij vendimi të plotë.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore, Gjykata në vlerësim të kriterëve të nenit 106, paragrafi i parë, të Kodit të Procedurës Civile konkludon se duhet t'u ngarkohen palëve të paditura solidarisht për shkak të disponimit nga kjo Gjykatë të pranimi të plotë të padisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 10, pika 2, germa “b”, 40, pika 1, germa “a”, 41, 42 e 43 të ligjit nr. 49/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*,

VENDOSI:

-Pranimin e padisë së Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

-Shfuqizimin e udhëzimit të përbashkët nr. 1665/1, datë 5.3.2014, *“Për caktimin e tarifave përmbartimore për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat”* të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave.

-Urdhërohet publikimi i këtij vendimi në Fletore Zyrtare nga Qendra e Botimeve Zyrtare.

-Shpenzimet gjyqësore palëve të paditura solidarisht.

-Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 36 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006